Mbledhjet e zakonshme të Asamblesë së Përgjithshme mbahen të paktën një herë në vit, në më të shumtën 6 muaj pas përfundimit të veprimtarive ekonomike-financiare, me qëllim që të analizojë bilancin dhe llogarinë e fitimit dhe humbjeve të vitit të mëparshëm dhe të përcaktojë planin dhe buxhetin për vitin në vazhdim.

Mbledhjet e jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme thirren (1) me kërkesën e aksionerëve, të cilët përfaqësojnë të paktën një të dhjetën (1/10) të kapitalit shoqëror, (2) me kërkesë të revizorëve ose (3) kur kapitali shoqëror zvogëlohet në shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) si rezultat i humbjeve.

Asamblea e Përgjithshme mbledhet me anë të letrave rekomande, telefakseve ose telekseve dërguar në adresat e aksionerëve nëpërmjet librit të llogarisë së Shoqërisë, të paktën 15 ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi do të përcaktojë datën, vendin dhe rendin e ditës së Asamblesë së Përgjithshme. Çdo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme e cila mund të thirret në mënyrë të papërshtatshme, mund të pezullohet me kërkesën e një aksioneri. Megjithatë, nëqoftëse të gjithë aksionerët janë të përfaqësuar në mbledhje dhe bien dakort, mbledhja mund të vazhdojë punimet e saj.

Asamblea e Përgjithshme e aksionerëve duhet të mbledhet në Selinë e Shoqërisë ose si të përcaktohet ndryshe.

Me vendim unanin të të gjithë aksionerëve, aksionerët mund të bien dakort të marrin vendime me shkrim pa thirrur Asamblesë e Përgjithshme; një dëshmi me shkrim e marrjes së këtij vendimi duhet t'i dërgohet Kryetarit dhe të regjistrohet në librat e Shoqërisë.

Artikulli 14. Kompetencat e veçanta të Asamblesë së Përgjithshme

Qëndtjet e mëposhtme janë brenda kompetencës ekskluzive të Asamblesë së Përgjithshme;

(a) Ndryshimet dhe/ose shtojcat e Statutit dhe/ose Aktit të Konstituimit të Shoqërisë, duke përfshirë ndryshimin e qëllimit të saj;

(b) Riorganizimi i Shoqërisë dhe likuidimi i saj;

(c) Orientimet bazë për kryerjen e afarismit;

(d) Shtimi dhe/ose pakësimi i kapitalit shoqëror;

(e) Miratimi i bilancit, deklaratimit të fitimit dhe humbjeve, raporti i kontroll revizionit, bilanci i likuidimit dhe të gjitha deklaratimet e tjera financiare të Shoqërisë.

(f) Mbulimi i humbjeve;

(g) Të gjitha vendimet lidhur me fondet e detyrueshme dhe vullnetare të Shoqërisë;

(h) Lëshimin e një dokumenti për derdhjen e kontributit nga ana aksionerit në kapitalin shoqëror dhe të certifikatës së pjesëve të tyre.

(i) Ngritjen e filialeve, degëve dhe zyrave të tjera të Shoqërisë si dhe pjesëmarrjen në entitete të tjera;

(j) Të gjitha vendimet lidhur me huatë që do të kontrahohen nga Shoqëria me përjashtim të kredisë normale të tregtisë të aplikueshme për operimin e Kompleksit Hotelierë-Tregtar.

(k) Caktimin e revizorëve;

(l) Shpërbllimin dhe/ose kompensimin e drejtorëve; dhe

(m) Të përfundojë çdo marrëveshje të kontraktuesit të përgjithshëm në emër të Shoqërisë.

Lidhur me qëndtjet e mësipërme, që janë brenda kompetencës ekskluzive të Asamblesë së Përgjithshme, Asambleja e Përgjithshme mund të veprë vetëm me vendim unanin të të gjithë pjesëmarrësve, që gëzojnë të drejtën e votës.

Të gjitha transaksionet e tjera të Asamblesë së Përgjithshme do të vendosen me shumicë të thjeshtë vote.

Hëqoftëse nuk do të arrihet numuri i caktuar i votave lidhur me qëndtjet që do të caktohen, meçlani duhet të votohet përsëri dhe,

nëqoftëse nuk arrihet përsëri, qështja do të vendoset nga Arbitrimi në përputhje me Nenin 27 në poshtë.

Neni 15. Organizimi i Asamblesë së Përgjithshme

Nëqoftëse nuk është parashikuar në Nenin 14 të Statutit:

a) Asambleja e Përgjithshme e zakonshme është e vlefshme dhe mund të marrë vendime në se në mbledhjen e saj aksionerët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të paktën dy të tretat e kapitalit shoqëror;

b) Asambleja e Përgjithshme e jashtëzakonshme është e vlefshme dhe mund të marrë vendime në se në mbledhjen e saj aksionerët apo përfaqësuesit e tyre kanë të paktën tre të katërtat e kapitalit shoqëror.

Asambleja e Përgjithshme kryesohet nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve dhe, në mungesë të tij, nga një prej Administratorëve, të caktuar nga Kryetari.

Kryetari cakton nga antarët e Asamblesë së Përgjithshme një sekretar, i cili duhet të mbajë proces verbalet e Asamblesë së Përgjithshme.

Proces verbalet do të shkruhen në një regjistër të vlefshur dhe të stampuar. Proces verbalet do të nënshkruhen nga personi që ka kryesuar mbledhjen dhe nga sekretari, i cili e ka mbajtur atë.

Neni 16. Ushtrimi i të drejtës së votës në Asamblenë e Përgjithshme

Vendimet merren me vota të hapura dhe në përputhje me aprovimin e nevojshëm sikurse deklarohet në Nenin 15. Mund të bëhet një kërkesë për konfirmimin e votës me shkrim.

Me proponent të personit kryesues apo të një grupi aksionerësh, të cilët janë të pranishëm apo të përfaqësuar dhe të cilët kanë të paktën 1/4 e kapitalit shoqëror, vota mund të jetë sekrete.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme janë të detyrueshme edhe për aksionerët që nuk janë të pranishëm.

Aksionerët mund të caktojnë me shkrim një person të tretë për t'i përfaqësuar atë në Asamblenë e Përgjithshme. Numuri i votave të secilit aksioner apo të përfaqësuesit të tij, përcaktohet nga pjesa që ka aksioneri në korporatë.

KAPITULLI V

Bordi i Drejtorëve

Neni 17. Organizimi

Sheqëria administrohet nga një person fizik (Drejtuesi i 25

i Përgjithshëm) ose disa persona fizike (Bordi i Drejtorëve). Secili aksioner do të përfaqësohet të paktën nga një drejtor. Bordi i Drejtorëve emërohet nga Asamblea e Përgjithshme.

Drejtorët mund të jenë të çdo kombësie dhe emërohen për një periudhë një vjeçare, është e mundur edhe emërimi i njëpasnjëshëm. Aksionerët mund t'i japin fund me shkrim emërimit të drejtorëve të tyre dhe t'i ndryshojnë ata në çdo kohë pa njoftuar për arsyet.

Kryetari zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve për një periudhë një vjeçare, është e mundur zgjedhja e njëpasnjëshme.

Të gjithë drejtorët kanë një numur votash të barabartë me pjesën e aksionerit që ata përfaqësojnë. Drejtorët mund t'ja u kalojnë të drejtat e votimit drejtorëve të tjerë apo personave të tretë me një dokument me shkrim.

Z. Robert Regner është emëruar si Drejtor i parë i Përgjithshëm.

Quorumi për transaksionin tregtar të Bordit të Drejtorëve kërkon praninë e një numuri drejtorësh - fizikisht apo me delegim - që përfaqësojnë të paktën 2/3 e aksioneve të titulluara për votë.

Në se janë disa drejtorë ata veprojnë në mënyrë kolektive në emër të Shoqërisë; çdo transaksion duhet të nënshkruhet të paktën nga dy drejtorë.

Neni 18. Vetimi

Të gjitha transaksionet e Bordit të Drejtorëve do të vendosen me shumicë të thjeshtë vote.

Në rast se ka barazi në votat lidhur me çështjen, mocioni duhet të votohet përsëri dhe, në rast se votat janë përsëri të barabarta, çështja do të vendoset nga Arbitrashi, në bazë të Nenit 27 në peshtë.

Neni 19. Shkarkimi

Antarët e Bordit të Drejtorëve mund të shkarkohen me tre të katërtat e votave të mbledhjes së jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme.

KAPITULLI VI

Administrimi Financiar i Shoqërisë

Neni 20. Revisorët

Administrimi financiar i Shoqërisë shqyrtohet nga Bordi i

Drejtorëve, Asamblea e Përgjithshme dhe revizorët. Asamblea e Përgjithshme, në bashkëveprim me Bordin e Drejtorëve, cakton një komision kontroll-revizioni në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për të kryer këtë veprimtari kontroll-revizioni, aksionerëve do t'u jepen, sipas kërkesës, të dhëna për veprimtari të financiare të Shoqërisë.

Komisioni i kontroll-revizionit ka autoritetin të revizionej të gjithë veprimtari dhe veprimet financiare të Shoqërisë dhe, për rrjedhojë të hartojë një raport dhe t'ja paraqesë atë Asamblesë së Përgjithshme.

Komisioni i kontroll-revizionit do të marrë një vendim unanim në se është e mundur. Në se nuk arrihet unanimitet, raporti me mendime kontradiktore do t'u paraqitet si Asamblesë së Përgjithshme ashtu dhe Bordit të Drejtorëve.

Të gjitha konstatimet e revizorëve do t'u raportohen si Asamblesë së Përgjithshme ashtu dhe Bordit të Drejtorëve.

KAPITULLI VII Veprimtaria e Shoqërisë

Neni 21. Veprimtaria ekonomiko-financiare

Veprimtaria ekonomiko-financiare fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti. Veprimtaria e parë financiare fillon në datën e themelimit të Shoqërisë.

Neni 22. Stafi i Shoqërisë

Stafi menaxhues do të miratohet nga Bordi i Drejtorëve. Pagimi i pagave, takeave mbi të ardhurat dhe kuota për sigurimet shoqërore do të bëhen në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 23. Mbajtja e librit dhe bilancit të llogarisë

Shoqëria do të mbajë librin e llogarisë në lekë dhe në valutë të huaj, sipas veprimtarisë së zhvilluar dhe, çdo vit do të bëjë bilancin e fitimit dhe humbjeve, si në bazë të normave metodologjike të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar ashtu dhe në përputhje me standartet e përlllogaritjes të pranuara përgjithësisht në industrinë hoteliere (Sistemi Uniform i llogarive të Industrisë hoteliere).

Neni 24. Përlllogaritja dhe Shpërndaerja e fitimit

Fitimi i Shoqërisë përcaktohet mbi bazën e bilancit të miratuar nga Asamblea e Përgjithshme. Shpërndarjet do të përcaktohen nga Asamblea e Përgjithshme. Aksionerët me kombësi të huaj gëzojnë të drejtën për të konvertuar në monedhë të huaj dhe të transferojnë të gjithë fitimin jashtë Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar për investitorët e huaj.

Nga fitimi vjetor, një fond rezervë duhet të caktohet në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar për fondet rezervë të detyrueshme.

KAPITULLI VIII

Modifikimi i Kuadrit Ligjor : Shpërndarja

Neni 25. Modifikimi i kuadrit ligjor

Shoqëria mund të ndryshohet në një formë tjetër Shoqërie me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas Nenit 14 këtu dhe në përputhje me dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

Shoqëria e re do të plotësojë regjistrimin ligjor dhe reklamën e nevojshme për Shoqërinë.

Neni 26. Shpërndarja e Shoqërisë

Shoqëria do të shpërndahet në bazë të rethanave të mëposhtme:

(a) Vendimit të marrë nga Asamblea e Përgjithshme sipas Nenit 14 këtu;

(b) Falimentimit; dhe

(c) humbjes së gjysmës së kapitalit shoqëror, mbasi është harxhuar fondi rezervë, po që se Asamblea e Përgjithshme nuk merr vendimin për plotësimin e kapitalit apo zvogëlimin e tij në shumën e mbetur në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Në rastin e shpërndarjes, Shoqëria do të likujdohet; një ose disa likuidues do të caktohen nga Asamblea e Përgjithshme.

Shumat që rezultojnë nga likuidimi do të përdoren së pari për shlyerjen e kreditorëve të privilegjuar (pagat dhe të drejta të tjera të personelit, taksat dhe detyrimet, sigurimet shoqërore, kështet dhe interesat e kredive, etj) dhe pastaj të kreditorëve të tjerë, duke përfshirë huatë e dhëna nga aksionerët e Shoqërisë. Pastaj, ajo që ka mbetur do të shpërndahet proporcionalisht me pronësinë e aksionerit në kapitalin shoqëror.

Në rastin e shpërndarjes së Shoqërisë, aksionerët e kombësisë

së huaj janë të titulluar të konvertojnë në valutë të huaj dhe të transferojnë jashtë Shqipërisë pa ndonjë kufizim të gjitha pasuritë që u takojnë në procesin e likuidimit në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar për investitorët e huaj.


KAPITULLI IX

Të Ndryshme

Neni 27. Arbitrazhi

Mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen nga aksionerët në lidhje me këtë Statut, Kontratën themeluese apo çdo veprimtari të Shoqërisë, do të vendoset përfundimisht nga një ose më shumë arbitra në përputhje me rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris, Francë. Vendi i Arbitrazhit do të jetë Paris dhe gjuha angleze.

Tiranë, më Qershor 1993.


Nga Klaus Reissmann

Autorizuar nga pushteti i Prokurorit
të themeluesit Rogner Ges.m.b.H.

STATUTI

I SHOQËRISË "SHQIPONJA ARTE" ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR (SHPK)

KAPITULLI I

Emri, Forma ligjore, Selia, Kohë zgjatja

Neni 1. Emri i Shoqërisë

Emri i Shoqërisë ("Shoqëri") është "Shqiponja Arte". Në të gjitha dokumentat, faturat, reklamimet dhe botimet e nxjerra nga Shoqëria, emërtimi i saj do të ketë përpara ose menjëherë pas tij, si më poshtë:

- (1) fjalët "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose "SHPK",
- (2) Numurin e regjistrimit dhe (3) Selinë.

Neni 2. Forma ligjore e Shoqërisë

Shoqëria tregtare "Shqiponja ARTE (SHPK)" është një person juridik shqiptar, që ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e këtij Statuti dhe të ndonjë akti tjetër të mëvonshëm.

Neni 3. Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë është: "Dëshmorët e Kombit 8, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria rezervon të drejtën të transferojë selinë e saj në një adresë dhe/apo qytet tjetër në Shqipëri.

Neni 4. Kohë zgjatja e Shoqërisë

Kohë zgjatja e shoqërisë është për një periudhë të pacaktuar kohe, deri sa i jepet fund nga Asambleja e Përgjithshme ose sikurse përcaktohet ndryshe në këtë Statut, duke filluar nga data e regjistrimit.

KAPITULLI II

Qëllimet e Shoqërisë

Neni 5. Qëllimet e Shoqërisë

Qëllimi i Shoqërisë është të ndërtojë dhe të operojë një Kompleks Hoteliero-Tregtar në Tiranë, Shqipëri, që do të përmbajë sipërfaqe hoteliere dhe tregtare, të tilla si zyra, dyqane dhe apartamente. Qëllimet e tjera të Shoqërisë do të përfshijnë afarizmin e import-eksportit për llogari të saj si dhe veprimtaritë e shërbimeve që kanë lidhje me funksionimin e Kompleksit Hoteliero-Tregtar.

si administrimi i pasurisë së patundshme dhe veprimtarisë e operatorëve të udhëtimeve turistike.

Për të siguruar standarte të klacit të parë ndërkombëtar në Kompleksin Hoteliero-Tregtar, aksioneri themelues do të verë në dispozicion të Kompanisë dijet e tij në fushat e ndërtimit dhe të veprimtarisë së funksionimit të hotelit. Në shtatë të këtij transferimi dimesh, Shoqëria do të përfundojë kontratën e Kontraktuocit të Përgjithshëm për Zhvillimin, Planifikimin dhe Ndërtimin e Kompleksit Hoteliero-Tregtar ekskluzivisht me Rogner Ges.m.b.H., Villach, Austri dhe kontratën e menaxhimit për funksionimin e Kompleksit Hoteliero-Tregtar në fjalë ekskluzivisht me Rogner International Ges.m.b.H., Vienë, Austri.

Neni 6. Modifikimi

Shoqëria rezervon të drejtën të modifikojë qëllimet e saj në çdo kohë sikurse parashikohet nga statuti.

KAPITULLI III

Kapitali Shoqëror ; Aksionet Shoqërore

Neni 7. Kapitali Shoqëror

Kapitali fillestar shoqëror i Shoqërisë do të jetë 100,000 (njëqind mijë) lek, i ndarë në 100 (njëqind) aksione shoqërore, vlera nominale e të cilave është 1,000 lek secila. Aksioneri Rogner Ges.m.b.H do të financojë kapitalin fillestar shoqëror në valutë të huaj, hollësitë për këtë jepen në mënyrë të specifikuar në Nenin 8 më poshtë.

Neni 8. Aksionet shoqërore

Aksionet shoqërore të aksionerëve janë si më poshtë:

(a) Nga Nr.1 deri në Nr.100 në vleftë prej 100,000 lek (100% e kapitalit shoqëror) përfaqëson kontributin e aksionerit të huaj Rogner Ges.m.b.H në formën e valutës së huaj që do të paguhet në llogarinë e shoqërisë në Bankën e Kursimeve të Shqipërisë, Tiranë.

Kontributi i aksionerëve në kapitalin shoqëror është në përputhje me Kontratën e Themelimit të Shoqërisë.

Administratori i Shoqërisë do të japë, po të kërkohet, një certifikatë vertetimi të ekzistencës së aksioneve shoqërore secilit prej aksionerëve, në certifikatë do të deklarohet:

- (a) Smërtimi dhe kohë zgjatja e Shoqërisë;
- (b) Data e themelimit dhe regjistrimit të shoqërisë, si dhe numuri i Gazetës Zyrtare ku është bërë publikimi, nëqoftëse një publikim i tillë kërkohet nga legjislacioni shqiptar;
- (c) Kapitalin shoqëror të Shoqërisë, numurin e pjesëve shoqërore, numurin e aksionerëve, sasinë e vlerës dhe pagesat e kryera; dhe
- (d) Emrin e Mbiemrin, adresën e aksionerëve.

Titujt do të kenë stampën e shtypur të Shoqërisë dhe do të nënshkruhen nga Kryetari i Shoqërisë. Shoqëria do të mbajë evidencën e aksioneve shoqërore në një libër llogarie të vulosur, i cili do të qëndrojë në selinë e Shoqërisë.

Neni 9. Zvogëlimi ose shtimi i kapitalit shoqëror

Kapitali shoqëror mund të rritet ose të zvogëlohet në përputhje me vendimet e marra nga Asamblea e Përgjithshme e aksionerëve, në përputhje me Kapitullin IV në poshtë dhe kërkesave të detyrueshme të legjislacionit shqiptar.

Shtimi i kapitalit shoqëror do të bëhet nëpërmjet lëshimit të certifikatave të reja të aksioneve shoqërore, që përfaqësojnë kontribut në të holla në dorë (cash) ose në natyrë, si dhe duke përfshirë rezerva apo fitime.

Aksionet e reja shoqërore do të vërtetohen në totalin e tyre dhe, vlera e tyre do të paguhet brenda një periudhe të caktuar nga Asamblea e Përgjithshme.

Neni 10. Të drejtat dhe detyrimet e Aksionerëve

Aksionerë janë vetëm ata të cilët kanë titujt e aksioneve shoqërore, të nxjerra ligjërisht nga Shoqëria.

Cdo titull i një aksioni shoqëror, i vërtetuar nga një aksioner, i jep atij të drejtën e një vote në asamblenë e përgjithshme të aksionerëve ("Asamblenë e Përgjithshme"), të drejtën për të zgjedhur e për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë (sipas këtij Statuti dhe dispozitave ligjore), si dhe të drejtën të tjera që parashikon ky Statut.

Aksionerëve do t'u jepet, po të bëjnë kërkesë me shkrim, informacion dhe të dhëna mbi veprimtarinë e Shoqërisë në çdo kohë, duke përfshirë të drejtën për të inspektuar të dhënat dhe dokumentat e Shoqërisë.

4

Të drojtat dhe detyrimet, që rezultojnë nga pronëria e aksioneve shoqërore, ndjekin aksionet në rast se ato ndryshojnë pronarin.

Detyrimet e Shoqërisë garantohehen nga kapitali i saj shoqëror dhe, aksionerët mund të jenë vetëm përgjegjës brenda limitit të vlerës që aksioneve shoqërore atë kanë; aksionerët nuk mbajnë përgjegjësi për optimin e investimit në Shoqëri (me përjashtim të garancive dhe huave që bëjnë ata).

Shoqëria nuk do të mbajë përgjegjësi për borxhet apo detyrime të tjera personale të aksionerëve të saj.

Neni 11. Transferimi i aksioneve shoqërore

Aksionet shoqërore nuk janë të ndashme në Shoqëri, e cila njihet vetëm një pronar për çdo aksion shoqëror.

Transferimi i pjesëshëm apo tërësor i aksioneve shoqërore midis aksionerëve mund të bëhet dakort nga aksionerët e përfshirë në transferim.

Secili aksioner mund të shesë, pretojë ose transferojë të gjitha ose pjesë të aksioneve të tij një pale të tretë, mjafton që:

- a) Pala e tretë pranon, në rastin e transferimit, në formë me shkrim, të gjitha kushtet e kësaj Kontrate dhe Statuti i Shoqërisë.
- b) Të gjithë aksionerët e tjerë bien dakort për transaksionin, një pëlqim i tillë të mos tërhiqet pa arsye.

Megjithatë, përpara se të shesë interesat e tij, aksioneri është i detyruar t'ja ofrojë ato me shkrim aksionerëve të tjerë me të njëjtat kushte që ai mendon t'ja transferojë palës së tretë. Aksionerët e tjerë duhet të informojnë aksionerin që bën shitjen për vendimin e tyre lidhur me të drejtat që kanë ata për të blerë përpara se të tjerët, vendim ky që bëhet me shkrim brenda 30 ditëve pas paraqitjes së ofertës, në të kundërt, miratimi konsiderohet si i dhënë.

Duke rënë dakort unanimisht, aksionerët mund të ndryshojnë kushtet e mësipërme e disponimit të aksioneve shoqërore në përputhje me kushtet e legjislacionit shqiptar.

Transferimi duhet të regjistrohet në librin e llogarisë të aksioneve shoqërore dhe kërkon një akt noterial në përputhje me legjislacionin shqiptar.

KAPITULLI IV

ASAMBLEA E PËRGJITHSHME

Neni 12. Pushtetet

5

i Shoqërisë, e cila merr vendime për veprimtarinë e saj dhe politikën e saj ekonomike e komerciale.

Asambleu e Përgjithshme do të ketë pushtetet e mëposhtme:

- (a) Të miratojë strukturën organizative të Shoqërisë dhe numarin e vendeve të punës;
- (b) Të caktojë antarët e Bordit të Drejtorëve dhe t'i shkaktojë ata me tre-të katërtat e votave të pjesëmarrëseve që gëzojnë të drejtën për votë.
- (c) Të marrë vendime për adoptimin apo modifikimin e Statutit dhe për ndryshimin e formës ligjore të Shoqërisë; ose
- (d) Të marrë çdo vendim tjetër për çdo problem tjetër që ka lidhje me Shoqërinë, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe kështu.

Meni 13. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleu e Përgjithshme mbledhet nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve ("Kryetari") ose nga një prej Administratorëve mbi bazën e një mandati të dhënë nga Kryetari.

Mbledhjet e zakonshme të Asamblesë së Përgjithshme mbahen të paktën një herë në vit, në më të shumtën 6 muaj pas përfundimit të veprimtarive ekonomiko-financiare, me qëllim që të analizojë bilancin dhe llogarinë e fitimit dhe humbjeve të vitit të mëparshëm dhe të përcaktojë planin dhe buxhetin për vitin në vazhdim.

Mbledhjet e jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme thirren (1) me kërkesën e aksionerëve, të cilët përfaqësojnë të paktën një të dhjetën (1/10) të kapitalit shoqëror, (2) me kërkesë të revizorëve ose (3) kur kapitali shoqëror zvogëlohet në shumë se 50% (pese-dhjetë përqind) si rezultat i humbjeve.

Asambleu e Përgjithshme mbledhet me anë të letrave rekomande, telefakseve ose telekseve dërguar në adresat e aksionerëve nëpërmjet librit të llogarisë së Shoqërisë, të paktën 15 ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi do të përcaktojë datën, vendin dhe rendin e ditës së Asamblesë së Përgjithshme. Çdo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme e cila mund të thirret në mënyrë të papërshtatshme, mund të pezullohet me kërkesën e një aksioneri. Megjithatë, nëqoftëse të gjithë aksionerët janë të përfaqësuar në mbledhje dhe bien dakort, mbledhja mund të vazhdojë punimet e saj.

Asambleu e Përgjithshme e aksionerëve duhet të mbledhet në Selinë e Shoqërisë ose si të përcaktohet ndryshe.

Me vendim unanim të të gjithë aksionerëve, aksionerët mund të bien dakort të marrin vendime me shkrim pa thirrur Asamblesë e Përgjithshme: një dëshmi me shkrim e marrjes së këtij vendimi duhet t'i dërgohet Kryetarit dhe të regjistrohet në librat e Shoqërisë.

Neni 14. Kompetencat e veçanta të Asamblesë së Përgjithshme

Çështjet e mëposhtme janë brenda kompetencës ekskluzive të Asamblesë së Përgjithshme:

(a) Ndryshimet dhe/ose shtojcat e Statutit dhe/ose Aktit të Konstituimit të Shoqërisë, duke përfshirë ndryshimin e qëllimit të saj;

(b) Riorganizimi i Shoqërisë dhe likuidimi i saj;

(c) Orientimet bazë për kryerjen e afarizmit;

(d) Shtimi dhe/ose pakësimi i kapitalit shoqëror;

(e) Miratimi i bilancit, deklaratit të fitimit dhe humbjeve, raporti i kontrolli revizionit, bilanci i likuidimit dhe të gjitha deklaratimet e tjera financiare të Shoqërisë.

(f) Mbulimi i humbjeve;

(g) Të gjitha vendimet lidhur me fondet e detyrueshme dhe vullnetare të Shoqërisë;

(h) Lëshimin e një dokumenti për derëhjen e kontributit nga ana aksionerit në kapitalin shoqëror dhe të certifikatës së pjesëve të tyre.

(i) Ngritjen e filialeve, degëve dhe zyrave të tjera të Shoqërisë si dhe pjesëmarrjen në entitete të tjera;

(j) Të gjitha vendimet lidhur me huatë që do të kontrahohen nga Shoqëria me përjashtim të kredisë normale të tregtisë të aplikueshme për operimin e Kompleksit Hoteliero-Tregtar.

(k) Caktimin e revizorëve;

(l) Shpërblimin dhe/ose kompensimin e drejtorëve; dhe

(m) Të përfundojë çdo marrëveshje të kontraktuesit të përgjithshëm në emër të Shoqërisë.

Lidhur me çështjet e mësipërme, që janë brenda kompetencës ekskluzive të Asamblesë së Përgjithshme, Asamblea e Përgjithshme mund të veprojë vetëm me vendim unanim të të gjithë pjesëmarrësve, që gëzojnë të drejtën e votës.

Të gjitha transaksionet e tjera të Asamblesë së Përgjithshme do të vendosen me shumicë të thjeshtë vote.

Nëqoftëse nuk do të arrihet numuri i caktuar i votave lidhur me çështjet që do të caktohen, mocioni duhet të votohet përsëri dhe,

7

nëqoftëse nuk arrihet përsëri, çështja do të vendoset nga Arbitrazhi në përputhje me Nenin 27 më poshtë.

Neni 15. Organizimi i Asamblesë së Përgjithshme

Nëqoftëse nuk është parashikuar në Nenin 14 të Statutit:

- a) Asamblea e Përgjithshme e zakonshme është e vlefshme dhe mund të marrë vendime në se në mbledhjen e saj aksionerët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të paktën dy të tretat e kapitalit shoqëror;
- b) Asamblea e Përgjithshme e jashtëzakonshme është e vlefshme dhe mund të marrë vendime në se në mbledhjen e saj aksionerët apo përfaqësuesit e tyre kanë të paktën tre të katërtat e kapitalit shoqëror.

Asamblea e Përgjithshme kryesohet nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve dhe, në mungesë të tij, nga një prej Administratorëve, të caktuar nga Kryetari.

Kryetari cakton nga antarët e Asamblesë së Përgjithshme një sekretar, i cili duhet të mbajë proces verbalet e Asamblesë së Përgjithshme.

Proces verbalet du të shkruhen në një regjistër të vullosur dhe të stampuar. Proces verbalet do të nënshkruhen nga personi që ka kryesuar mbledhjen dhe nga sekretari, i cili e ka mbajtur atë.

Neni 16. Ushtimi i të drejtës së votës në Asamblenë e Përgjithshme

Vendimet merren me vota të hapura dhe në përputhje me aprovimin e nevojshëm sikurse deklarohet në Nenin 15. Mund të bëhet një kërkesë për konfirmimin e votës me shkrim.

Me propozim të personit kryesues apo të një grupi aksionerësh të cilët janë të pranishëm apo të përfaqësuar dhe të cilët kanë të paktën 1/4 e kapitalit shoqëror, vota mund të jetë sekrete.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme janë të detyrueshme edhe për aksionerët që nuk janë të pranishëm.

Aksionerët mund të caktojnë me shkrim një person të tretë për t'i përfaqësuar ata në Asamblenë e Përgjithshme. Numuri i votave të secilit aksioner apo të përfaqësuesit të tij, përcaktohet nga pjesa që ka aksioneri në korporatë.

KAPITULLI V

Bordi i Drejtorëve

Neni 17. Organizimi

i përgjithshëm) ose disa persona fizike (Bordi i Drejtorëve). Secili aksioner do të përfaqësohet të paktën nga një drejtor. Bordi i Drejtorëve ve emërohet nga Asamblea e Përgjithshme.

Drejtorët mund të jenë të çdo kombësie dhe emërohen për një periudhë një vjeçare, është e mundur edhe emërimi i njëpasnjëshëm. Aksionerët mund t'i japin fund me shkrim emërimit të drejtorëve të tyre dhe t'i ndryshojnë ata në çdo kohë pa njoftuar për arsyet.

Kryetari zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve për një periudhë një vjeçare, është e mundur zgjedhja e njëpasnjëshme.

Të gjithë drejtorët kanë një numur votash të barabartë me pjesën e aksionerit që ata përfaqësojnë. Drejtorët mund t'ja u kalojnë të drejtat e votimit drejtorëve të tjerë apo personave të tretë me një dokument me shkrim.

Z. Robert Rogner është emëruar si Drejtor i parë i Përgjithshëm

Quorumi për transaksionin tregtar të Bordit të Drejtorëve kërkon praninë e një numuri drejtorësh - fizikisht apo me delegim - që përfaqësojnë të paktën 2/3 e aksioneve të titulluara për votë.

Në se janë disa drejtorë ata veprojnë në mënyrë kolektive në emër të Shoqërisë; çdo transaksion duhet të nënshkruhet të paktën nga dy drejtorë.

Neni 18. Votimi

Të gjitha transaksionet e Bordit të Drejtorëve do të vendosen me shumicë të thjeshtë vote.

Në rast se ka barazi në votat lidhur me çështjen, mocioni duhet të votohet përsëri dhe, në rast se votat janë përsëri të barabarta, çështja do të vendoset nga Arbitrazhi, në bazë të Nenit 27 më poshtë.

Neni 19. Shkarkimi

Antarët e Bordit të Drejtorëve mund të shkarkohen me tre të katërtat e votave të mbledhjes së jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme.

KAPITULLI VI

Administrimi Financiar i Shoqërisë

Neni 20. Revizorët

Administrimi financiar i Shoqërisë shqyrtohet nga Bordi i

Drejtorëve, Asamblea e Përgjithshme dhe revizorët. Asamblea e Përgjithshme, në bashkëveprim me Bordin e Drejtorëve, cakton një komision kontroll-ravizioni në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për të kryer këtë veprimtari kontroll-ravizioni, aksionerëve do t'u jepen, sipas kërkesës, të dhëra për veprimtarinë financiare të Shoqërisë.

Komisioni i kontroll-ravizionit ka autoritetin të ravizionojë të gjithë veprimtarinë dhe veprimet financiare të Shoqërisë dhe, për rrjedhojë të hartojë një raport dhe t'ja paraqesë atë Asamblesë së Përgjithshme.

Komisioni i kontroll-ravizionit do të marrë një vendim unanimitet nëse është e mundur. Nëse nuk arrihet unanimitet, raporti me mendimet kontradiktore do t'u paraqitet si Asamblesë së Përgjithshme ashtu dhe i Bordit të Drejtorëve.

Të gjitha konstatimet e revizorëve do t'u raportohen si Asamblesë së Përgjithshme ashtu dhe Bordit të Drejtorëve.

KAPITULLI VII

Veprimtaria e Shoqërisë

Neni 21. Veprimtaria ekonomiko-financiare

Veprimtaria ekonomiko-financiare fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti. Veprimtaria e parë financiare fillon në datën e themelimit të Shoqërisë.

Neni 22. Stafi i Shoqërisë

Stafi monaxhues do të miratohet nga Bordi i Drejtorëve. Pagimi i pagave, taksave mbi të ardhurat dhe kuota për sigurimet shoqërore do të bëhen në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 23. Mbajtja e librit dhe bilancit të llogarisë

Shoqëria do të mbajë librin e llogarisë në lekë dhe në valutë të huaj, sipas veprimtarisë së zhvilluar dhe, çdo vit do të bëjë bilancin e fitimit dhe humbjeve, si në bazë të normave metodologjike të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar ashtu dhe në përputhje me standartet e përlllogaritjes të pranuarë përgjithësisht në industrinë hoteliere (Sistemi Uniform i llogarive të Industrisë hoteliere).

Neni 24. Përlllogaritja dhe Shpërndarja e fitimit

Fitimi i Shoqërisë përcaktohet mbi bazën e bilancit të miratuar nga Asamblea e Përgjithshme. Shpërndarjet do të përcaktohen nga Asamblea e Përgjithshme. Aksionerët me kombësi të huaj gëzojnë të drejtën për të konvertuar në monedhë të huaj dhe ta transferojnë të gjithë fitimin jashtë Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar për investitorët e huaj.

Nga fitimi vjetor, një fond rezervë duhet të caktohet në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar për fondet rezervë të detyrueshme.

KAPITULLI VIII.

Modifikimi i Kuadrit Ligjor : Shpërndarja

Neni 25. Modifikimi i kuadrit ligjor

Shoqëria mund të ndryshohet në një formë tjetër Shoqërie me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas Nenit 14 këtu dhe në përputhje me dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

Shoqëria e re do të plotësojë regjistrimin ligjor dhe reklamën e nevojshme për Shoqërinë.

Neni 26. Shpërndarja e Shoqërisë

Shoqëria do të shpërndahet në bazë të rethanave të mëposhtme:

(a) Vendimit të marrë nga Asamblea e Përgjithshme sipas Nenit 14 këtu;

(b) Falimentimit; dhe

(c) humbjes së gjysmës së kapitalit shoqëror, mbasi është harxhuar fondi rezervë, po që se Asamblea e Përgjithshme nuk marr vendimin për plotësimin e kapitalit apo zvogëlimin e tij në shumën e mbetur në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Në rastin e shpërndarjes, Shoqëria do të likujdohet; një ose disa likuidues do të caktohen nga Asamblea e Përgjithshme.

Shumat që rezultojnë nga likuidimi do të përdoren së pari për shlyerjen e kreditorëve të privilegjuar (pagat dhe të drejta të tjera të personelit, taksat dhe detyrimet, sigurimet shoqërore, këstet dhe intesitetat e kredive, etj) dhe pastaj të kreditorëve të tjerë, duke përfshirë huatë e shëna nga aksionerët e Shoqërisë. Pastaj, ajo që mbetet do të shpërndahet proporcionalisht me pronësinë e aksionerit në kapitalin shoqëror.

Në rastin e shpërndarjes së Shoqërisë, aksionerët e kombësisë

të huaj janë të vitulluar të konvertojnë në valutë të huaj dhe të transferojnë jashtë Shqipërisë pa ndonjë kufizim të gjitha pasuritë që u takojnë në procesin e likuidimit në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar për investitorët e huaj.

KAPITULLI IX

Të Ndryshme

Neni 27. Arbitrazhi

Mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen nga aksionerët në lidhje me këtë Statut, Kontratën themeluese apo çdo veprimtari të Shoqërisë, do të vendoset përfundimisht nga një ose më shumë arbitra në përputhje me rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris, Francë. Vendi i Arbitrazhit do të jetë Paris dhe gjuha angleze.

Tiranë, më

qershor 1993.


Nga Klaus Rössmann

Autorizuar nga pushteti i Prokurorit
të themeluesit Rogner Ges.m.b.H.

SHTOJCA 1

Sipas vendimit te ROGNER GmbH per t'i bere ndryshime Statutit te "Golden Eagle sh.p.k."
(Vendimi i Themeluesit)

Tirane, me 13 Korrik 1994

Nenet qe vijojne te Statutit te Shoqerise "Shqiponja e Arte" SH.P.K. siç eshte regjistruar ne Gjykatën e Rrethit Tirane, ndryshojne si meposhte:

Neni 1. Emri i Shoqerise

1.1. Emri i Shoqerise ("Shoqeri") eshte "Shqiponja e Arte". Ne te gjitha dokumentat, faturat, reklamat dhe botimet e nxjerra nga Shoqeria, emri i saj do te paraprihet ose pasohet menjehere nga:

(a) Fjalet "Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar" ose Sh.p.k.

(b) Selia.

Neni 2. Selia e Shoqerise

2.1. Selia e Shoqerise eshte ne Rruga "Mustafa Matohiti", Vila 2, Tirane, Shqiperi. Shoqeria rezervon te drejten te transferoje seline e saj ne nje adrese dhe/apo qytet tjeter te Shqiperise.

Neni 3. Kohezgjatja e Shoqerise

3.1. Kohezgjatja e Shoqerise eshte caktuar per 100 vjet nga data e krijimit te saj. Kjo kohe mund te zgjatet me tej me nje vendim unanim te ortakeve.

Neni 4. Objektivat e Shoqerise

4.1. Objektivi kryesor i Shoqerise eshte te ndertoje dhe te operoje nje kompleks Hotelier - Tregetar ne Tirane, Shqiperi qe do te perfshije nje siperfaqe hoteliere dhe tregetare, e cila do te kete zyra, dyqane dhe apartamente. Objektiva te tjera te Shoqerise do te perfshijne afarizmin e import-eksportit qe kane lidhje me veprimin e Kompleksit Hotelier-Tregetar, te tilla si administrimi i pasurise se patundeshme dhe veprimtarite e operatorit te udhetimeve turistike.

Kapitali Themelor, pjeset ne Kapitalin Themelor

Neni 5. Kapitali Themelor

5.1. Kapitali i Shoqerise eshte dhjete mije (10.000) Dollare Amerikane i perbere prej dhjete (10) Pjesesh te Zakoneshme ne vlere te barabarte prej 1.000 (njemije USD) secila, plotesishte te nenshkruara dhe te vlefeshme.

Neni 6. Pjeset e Kapitalit themelor

6.1. Pjeset e Kapitalit Themelor mund te jene Pjese te Zakoneshme ose Pjese te Preferueshme te Serise B.

6.2. Percaktimi

Pjeset e Preferueshme te Serise B, kane nje vlere te barabarte prej 1000 USD per secilen, keto pjese te Serise B, ashtu sikuresse te gjitha pjeset e tjera, do te konsiderohen pjese nacionale dhe jo si sigurime apo apo banknota brenda kuptimit te Nenit 44 te Ligjit mbi Shoqerite Tregtare te Shqiperise. Numri i pjeseve te serise B, i autorizuar per te nxjerre do te jete 2.500.

6.3. Radhitja

Pjeset e Serise B, si rezultat i likujdimit, shperndarjes apo perfundimit, do te radhiten perpara Pjeseve te Zakoneshme (me perpara te njohura edhe si Pjese Ekzistuese te Ri-vleresuara dhe/ose Pjese te reja te Serise A) si edhe perpara Pjeseve te tjera qe here pas here mund te autorizohen nga Shoqeria (te gjitha ketyre Pjeseve do t'u referohemi ne menyre te permbledhur si "Sigurime te reja")

6.4. Likujdimi

Ne rast te ndonje likujdimi, shperndarje apo perfundimi te vullnetshem apo te pavullnetshem te afarizmit te Shoqerise, mbajtesit e Pjeseve te Serise B, qe do te rezultojne te vlefeshme, do te gezojne te drejten qe te paguhen nga pasurite qe disponon Shoqeria per t'u shperndare ortakeve te saj dhe shumen ne te holla ne dore (Kesh) te barabarte me vleften nominale te dollarit per çdo pjese te vlefshme, plus dividendet e rritura dhe te papaguara deri ne daten e caktuar per likujdimin, shperndarjen apo perfundimin, perpara se te jete bere ndonje pagese apo te jete shperndare çfardo pasurie tek ndonje prej mbajtesve te Sigurimeve te Reja.

Nuk gjen zbatim Neni 276 i Ligjit Nr.7368 i vitit 1992 dhe ai nuk mund te paragjykoje te drejttat e ortakeve te Serise B ne rast te likujdimit te Shoqerise.

6.5. Te drejttat e votimit

(a) Çdo pjese e Serise B do t'i njohe te drejten mbajtesit te kete nje vote dhe te marre njoftim per çdo mbledhje te ortakeve.

(b) Perveç ndonje te drejte tjeter te parashikuar nga ligji i zbatueshem apo ndryshe, nese edhe per sa kohe qe ndonje pjese e Serise B do te jete e



konsolidimit, riorganizimit ose ndonje transaksioni tjetër me ndonje apo me shume persona, pa votën paraprake pro apo për qëllimin me shkrim të ortakeve që kanë jo më pak se 75% të numrit të përgjithshëm të pjesëve të Serisë B në kohën kur ato kanë rezultuar të vlefshme, nuk do të:

- (i) Shtojë numrin e autorizuar të Pjesëve të Serisë B,
- (ii) Autorizojë, krijojë ose nxjerrë pjesë të ndonje klase pjesësh që ka ndonje preferencë apo prioritet ndaj dividendëve apo shpërndarjes së pasurive përpara ose në bazë barazie me ndonje preferencë ose prioritet që ka lidhje me pjesët e Serisë B, ose autorizojë, krijojë ose nxjerrë pjesë të ndonje klase apo ndonje bankenote, sëneta, kartemonedhe, obligacione apo forma të tjera sigurimi të konvertueshme apo të shkëmbyeshme, ose që kanë opsionin e të drejtave për të kërkuar ndarjen e stokut të Shoqërisë, i cili ka ndonje preferencë apo prioritet ndaj dividendëve, obligacioneve ose pasurive përpara ose në bazë barazie me ndonje preferencë ose prioritet që lidhet me Pjesët e Serisë B.
- (iii) deklarojë, paguajë ose mbajë rezerve për pagimin dhe dividendin e ndonje prej pjesëve të kapitalit stok të Shoqërisë (duke përfshirë pa kufizim Sigurimet e Reja) ose të bëjë ndonje pagesë për llogari ose të mbajë rezerva për pagimin e hollave për fonde në rënie ose për ndonje fond tjetër të ngjashëm, ose të kërkojë ndonje prej pronave lidhur me blerjen, përmbushjen, anulimin ose përfitimin tjetër të ndonje prej pjesëve të kapitalit stok të Shoqërisë (duke përfshirë pa kufizim Sigurimet e Reja) ose të bëjë drejtpërsëdrejti ose indirekt ndonje shpërndarje për këtë qëllim që të në para në dorë, obligacione, aksione ose sigurime të Shoqërisë, që të në pasuri të tjera dhe, nuk do të lejojë ndonje person tjetër i kontrolluar drejtpërsëdrejti ose indirekt nga Shoqëria, të blejë, përmbushë, anulojë ose ndryshojë të kërkojë drejtpërsëdrejti ose indirekt ndonje prej aksioneve të kapitalit stok të Shoqërisë (duke përfshirë pa kufizim Sigurimet e Reja).
- (iv) Të riklasifikojë çfarëdo Sigurimesh të Reja në pjesë që kanë ndonje preferencë ose prioritet ndaj dividendëve apo shpërndarjes së pasurive përpara ose në bazë barazie me ndonje preferencë apo prioritet lidhur me Pjesët e Serisë B; ose
- (v) Të ndryshojë, ndryshojë ose hedhë poshtë ndonje dispozite të Statutit, që do të cenohet drejtpërsëdrejti ose indirekt qëllimet, kompetencat, preferencat, të drejtat, cilësimet, kufizimet dhe restriksionet e Pjesëve të Serisë B (duke përfshirë pa kufizim, autorizimet ose krijimin e klasave ose serive të Pjesëve të zakonshme të ndryshme nga ato të përshkruara deri tani).

6.6. Transferimi

Ne transferimin e titullit nga njeri nenshkruer i Pjeseve te Serise B automatikisht dhe ne menyre te pakthyeshme shendrohen ne Pjese te Zakoneshme.

Neni 7. Zvogelimi dhe zmadhimi i Kapitalit Themeltar

7.1. Kapitali Themelor mund te zmadhohet ose zvogelohet ne perputhje me vendimet e marra nga Asamblea e Pergjitheshme e Ortakeve, ne perputhje me Kapitullin IV me poshte dhe kerkesave te detyrueshme te legjislacionit shqiptar.

7.2. Kapitali Themelor do te zmadhohet duke nxjerre certifikata te reja pjesesh, qe perfaqesojne para ne dore (Kesh) ose kontribute ne natyre, si dhe duke perfshire rezerva ose fitime.

7.3. Pjeset e reja do te nenshkruhen dhe vlere e tyre e barabarte do te plotesohet perpara se te miratohet vendimi i Ortakeve per regjistrimin e zmadhimit te kapitalit.

Neni 8. Transferimi i pjeseve te Kapitalit Themeltar

8.1. Pjeset mund te jene lirisht te transferueshme ndermjet Ortakeve ne perputhje me ligjin shqiptar Nr.7638 te vitit 1992.

8.2. Pjeset mund t'ju transferohen personave te trete jo ortake me pelqimin e te gjithe ortakeve te tjere, Shoqerise dhe secilit ortak duhet t'i njoftohet propozimi i shitjes te pjeseve me perpara, me leter rekomande me gjithe informacionin e nevojshem. Ortaket duhet te miratojne ose te kundersizojne transferimin e propozuar brenda tre muajve nga marja e njoftimit. Nese nuk eshte mare ndonje vendim gjate periudhes tremujore, transferimi konsiderohet si i miratuar. Nese ortaket kundersizojne shitjen e propozuar, do te zbatohen dispozitat perkatese te Ligjit mbi Shoqerite Tregtare Shqiptare.

8.3. Si rrjedhim, krijohet nje "Liber i Ortakeve", ku te gjithe Ortaket duhet te regjistrojne pjeset qe ata kane ne Shoqeri. Me qellim qe te konsiderohen si Ortake, secili person si prone nje ose me shume Pjese ne Shoqeri duhet te regjistroje Titullin ne librin e ortakeve.

8.4. Çdo regjistrim ne liber duhet te tregojte emrin e Ortakut, shumen e pjeseve qe ka ky Ortak i veçante dhe formen e transaksionit me anen e se ciles u posedua kjo prone. Libri mbahet nga sekretari i Shoqerise, i cili duhet t'u jape nje kopje te njejte secilit prej ortakeve qe e kerkojne ate. Çdo regjistrim ne liber regjistrohet dhe nenshkruhet nga Krytari i Bordit te Drejtoreve (ose Drejtori Menaxhues nese nuk eshte zgjedhur akoma Bordi i Drejtoreve) te Shoqerise me t'u paraqitur nga Ortaket perkates nje dokument qe verteton se posedon si prone pjese.

8.5. Perveç formaliteteve të mesiperme, çdo ortak i kërkohej gjithashtu të regjistrojë në regjistrin e Shoqërisë në Gjykatën e Tiranës shumën e pjesëve që ka në shoqëri, duke i bashkëlidhur regjistrin një kopje të dokumentit që provon titullin e tij. Enjejtat procedurë duhet të ndiqet përsa i përket ndonjë pengë të ndonjë pjesë të Shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme

Neni 9. Kompetencat

9.1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi kontrollues i Shoqërisë, e cila mer vendime për veprimtarinë e saj.

9.2. Asambleja e Përgjithshme do të ketë kompetencat e mëposhteme:

- (a) të miratojë strukturën organizative të Shoqërisë dhe numrin e vendeve të punës;
- (b) të emerojë dhe shkarkojë anëtarët e Bordit të Drejtoreve;
- (c) të marrë vendime për adoptimin ose modifikimin e Statutit dhe për ndryshimin e formës juridike të Shoqërisë; ose
- (d) të marrë çdo vendim tjetër për çdo problem tjetër që ka lidhje me Shoqërinë, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe këtu.

Neni 10. Mbledhja e Asamblese së Përgjithshme

10.1. Asambleja e Përgjithshme mbledhet nga Kryetari i Bordit të Drejtoreve (Kryetari) ose nga një prej Administratoreve mbi bazën e një mandati të dhënë nga Kryetari.

10.2. Mbledhjet e zakonshme të Asamblese së Përgjithshme mbahen të pakten një herë në vit, në mënyrë të shumtën 6 muaj pas përfundimit të periudhës ekonomiko-financiare, me qëllim që të analizojë bilancin dhe llogaritë e fitimit dhe humbjeve të vitit të mëparshëm dhe të përcaktojë planin dhe buxhetin për vitin në vazhdim.

10.3. Mbledhjet e jashtëzakonshme të Asamblese së përgjithshme thirren (1) me kërkesën e aksionerëve që përfaqësojnë të pakten një të dhjetën (1/10) e kapitalit themelor, (2) me kërkesën e ekspertëve kontabel ose (3) kur kapitali themelor zvogëlohet me shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) si rezultat i humbjeve.

10.4. Njoftimi për çdo mbledhje të Asamblese së përgjithshme duhet t'u dërgohet ortakëve me leter rekomandë, telefaks ose teleks në adresën e përmendur nga ortakët në Librin e Shoqërisë të pakten 15 ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi do të përcaktojë datën, vendin dhe rendin e ditës të asamblese së Përgjithshme. Çdo mbledhje e Asamblese së Përgjithshme që mund të

thiret ne menyre te papershtateshme, mund te pezullohet me kerkesen e nje ortak. Megjithate, neqoftese te gjithë ortakët janë te perfaqesuar ne mbledhje dhe bien dakort, mbledhja mund t'i vazhdoje punimet e saj.

10.5. Mbledhja e Asamblese se Pergjitheshme zhvillohet ne seline e Shoqerise ose si te percaktohet ndryshe.


10.6. Ne mbledhjet e ortakeve, nje ortak mund te votoje drejtpersedrejti ose me ane te nje dokumenti me shkrim dhe te derguar çdo pale te trete ose çdo ortakut tjetër.

10.7. Neni 57 i ligjit shqiptar Nr.7648 te vitit 1992 qe per vendimet e ortakeve qe mund te merren pas konsultimeve me shkrim, do te vepohet si meposhte. Vendimet qe propozohen do te qarkullojne ne formen e shkruar tek te gjithë ortakët nepermjet faksit, teleksit ose letres rekomande, dhe keto vendime do te konsiderohen te pranuar nese do te miratohen me shkrim prej te gjithë ortakeve. Çdo ortakut i kerkohet te jape vendimin e tij me shkrim te Kryetari, me ane te faksit ose teleksit te konfirmuar me leter rekomande. Vendimi duhet te jete i qarte dhe i pakushtezuar dhe, duhet te deklarohet qarte nese deklaruesi eshte ne favor apo kunder ketij vendimi te caktuar. Kryetari do te mbledhe vendimet pro dhe kunder, dhe do te komunikojë rezultatin e konsultimit. Secili drejtor dhe ortak i Shoqerise ka te drejte te inspektojë proces-verbalet lidhur me nje konsultim te caktuar me shkrim.

Neni 11. Kompetencat e veçanta te Asamblese se Pergjitheshme

11.1. Çështjet e meposhteme janë brenda kompetences ekskluzive te Asamblese se Pergjitheshme dhe nuk mund t'i delegohen Bordit te Drejtoreve:

- (a) Ndryshimet dhe/ose amendamentet e Statutit dhe/ose Aktit te konstituimit te Shoqerise;
- (b) Riorganizimi i Shoqerise dhe perfundimi ose likuidimi i saj;
- (c) Orientimet baze me anen e te cilave Shoqeria kryen afarizmin e saj;
- (d) Zmadhimi ose zvogelimi i Kapitalit Themelor;
- (e) Miratimit te bilancit, deklarimit te fitimit dhe humbjeve, raportit te kontroll revizionit, bilancit te likuidimit dhe te gjitha deklarimet e tjera financiare te Shoqerise;
- (f) Mbulimi i humbjeve;
- (g) Te gjitha vendimet lidhur me fondet e detyrueshme dhe vullnetare te Shoqerise;
- (h) Leshimin e nje dokumenti per derdhjen e kontributit nga ana e ortakut ne kapitalin themelor dhe te certifikates se interesave te tyre;
- (i) Ngritjen e filjaleve, degeve dhe zyrave te tjera te Shoqerise si dhe pjesemarrjen ne njesi te tjera;
- (j) Te gjitha vendimet lidhur me huate qe do te kontraktohen nga Shoqeria, me perjashtim te kredise



- normale te tregetise te aplikueshme te aplikueshme per operimin e kompleksit Hotelier-Tregetar;
- (k) Caktimin e eksperteve kontabel;
 - (l) Shperblimin dhe/ose kompensimin e drejtoreve;
 - (m) Te perfundoje çdo marreveshje te kontraktuesit te pergjithshem ne emer te Shoqerise;
 - (n) Te perfundoje dhe/ose te hyje ne ndonje kontrate menaxhimi hotelier dhe/ose zyre;
 - (o) Emerimin ose shkarkimin e drejtoreve;
 - (p) Ndermarrjen e aktiviteteve te reja afariste dhe/ose operacioneve te reja;
 - (q) Venjen ne hipoteke, peng apo sigurim tjetër te ngjashem;
 - (r) Blerjen e pronave te paluejtshme;
 - (s) Blerjen e pjeseve te shoqerive te tjera;

11.2. Persa i perket çeshtjeve te rrjeshtuara ne 11.1. duke filluar nga (a) deri ne (s), te gjitha vendimet do te miratohen me vendim unanim te te gjitha aksioneve te vlefshme qe gezojne te drejten e votes.

11.3. Te gjitha transaksionet e tjera te Asamblese se Pergjitheshme do te vendosen me shumice te thjeshte vote.

11.4. Ne goftese nuk do te arrihet numri i caktuar i votave lidhur me çeshtjet per te cilat do te merret vendimi, mocioni do te votohet perseri dhe, ne rast se kjo nuk arihet prape, çeshtja do te vendoset nga Arbitrazhi ne perputhje me Nenin 18 me poshte.

Bordi i Drejtoreve

Neni 12. Organizimi

12.1. Shoqeria menaxhohet nga Bordi i Drejtoreve, qe perbeht prej tre anetaresh te caktuar me vendim te aksionereve.


12.2. Drejtoret mund te jene te çdo kombesie dhe nuk ka pse te jene rezidente shqiptare. Ata zgjidhen per nje vit dhe mund te rimerohen.

12.3. Drejtoret mund te zgjedhin midis tyre Kryetarin e Shoqerise.. Kryetari zgjidhet per nje vit dhe mund te rimerohet.

12.4. Mbledhjet e Bordit thirren me kerkesen e çdo drejtori, nga ana e Kryetarit, i cili do te caktoje gjithashtu kohen dhe vendin e takimit. Mbledhjet mund te zhvillohen brenda ose jashte Shqiperise.

12.5. Çdo veprim qe kerkohet ose lejohet te merret nga Bordi i Drejtoreve ne nje mbledhje te Bordit, mund te merret edhe pa u zhvilluar mbledhja, me ane te konsultimit me shkrim. Vendimet e propozuara do t'u dergohen me shkrim te gjithe Drejtoreve me faks, teleks ose poste rekomande

dhe keto vendime do te konsiderohen si te mireqena nese miratohen me shkrim nga te gjitha Drejtoret e Shoqerise. Secilit Drejtor do t'i kerkohet t'ia transmetoje vendimin e tij me shkrim Kryetarit, me ane te faksit ose teleksit te konfirmuar me leter rekomande. Ky vendim duhet te jete shprehur qarte dhe i pakushtezuar dhe te shprehi qarte nese votuesi eshte ne favor apo kundra nje vendimi te caktuar. Kryetari do te grumbulloje qendrimet pro dhe kundra dhe do te komunikojte rezultatin e konsultimit. Secili Drejtor dhe Pjestar i Shoqerise ka te drejte te inspektojte rezultatet e çdo konsultimi me shkrim.

 Neni 13. Votimi

13.1. Secili Drejtor gezon te drejten e nje vote.

13.2. Vendimet apo veprimet e meposhteme te Bordit te Drejtoreve jane te vlefshme te merren me pelqimin unanim te te gjitha Drejtoreve:

(a) Institucionalizimin e procedurave ligjore te çdo tipi dhe natyre;

(b) Ndertimin e ndertesave te reja ne pronat e marra me qira apo ndryshime ne keto prona ose transformimin e saj;

(c) Çdo amendament, ndryshim, alternativim, perfundim ose mosnjohje e te drejtave baze te çdo marreveshje te pergjitheshme te kontraktuesve, marreveshje menaxhimi hotelier dhe/ose zyre, marreveshje kredie, marreveshje qiraje ose marreveshje te venjes ne hipoteke, peng apo sigurimi tjeter.

13.3. Te gjitha vendimet apo veprimet e tjera te Bordit te Drejtoreve vendosen me shumice te thjeshte vote.

13.4. Ne rast se nuk arrihet dhenja e miratimit unanim ose shumica e kerkuar e drejtoreve dhe kjo gjendje vazhdon edhe ne mbledhjen e ardheshme te Bordit, çeshtja do te paraqitet ne Arbitrazh ne perputhje me Nenin 18 me poshte.

Neni 14. Shkarkimi

14.1. Drejtoret mund te shkarkohen me ose pa shkak me vendim te ortakeve.

Administrimi Financiar i Shoqerise

Neni 15. Ekspertet kontabel

15.1. Ortaket do te caktojne eksperte kontabel ne numer dhe per kohen e percaktuar nga legjislacioni shqiptar.

15.2. Ekspertet kontabel do te kryejne funksionet e kontrollit ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Veprimtaria e Shoqerise

Neni 16. Mbajtesit elibrit te llogarise

16.1. Shoqeria do te mbaje librin e llogarise ne lek dhe ne valute te huaj dhe do te nxjerre bilancin dhe perlllogaritjet e fitimit dhe humbjes ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Por nese kerkohet prej marreveshjeve te huas me banka nderkombetare ose marreveshje te tjera te perfunduara nga Golden Eagle Sh.p.k., Shoqeria do te paraqese rezultatet ne keto libra llogarise ne perputhje me standartet e perlllogaritjes te pranuar per gjithesisht ne industrine hoteliere (sistemi uniform i llogarive te industrise hoteliere).

Modifikimi i formes ligjore: Shperndarja

Neni 17. Modifikimi i formes ligjore

17.1. Forma ligjore e shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjitheshme sipas Nenit 11 ketu dhe ne perputhje me dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar.

17.2. Shoqeria e re do te plotesoje te gjitha procedurat e regjistrimit qe ligjerisht kerkohen ne Shqiperi.

Te ndryshme

Neni 18. Arbitrazhi

18.1. Çdo marreveshje, konflikt ose pretendim midis Shoqerise dhe nje ose me shume ortakeve te huaj ose midis ortakeve te huaj qe lind prej ose ka lidhje me kete Statut ose shkelje, zgjidhje ose pavlefshmeri, do t'i paraqitet dhe do te zgjidhet perfundimisht nga Arbitrazhi ne perputhje me rregullat e Arbitrazhit te UNCITRAL-it ne fuqi dhe qe veprojne ne daten e kesaj Marreveshje. Do te kete Arbitrer dhe, autoriteti i caktuar ne kuptimin e rregullave te UNCITRAL-it do te jete Gjykata e Arbitrazhit Nderkombetar ne Londer. Kur Rregullat e Arbitrazhit te UNCITRAL-it nuk e parashikojne nje situatë te veçante, Arbitri me gjykimin e tij absolut, do te percaktoje se cila do te jete rrjedha e procedimit dhe, Vendimi i arbitrit do te jete perfundimtar. Vendi i Arbitrazhit do te jete Londra ose Tirana sipas zgjedhjes se pales paditese. Gjuha angleze do te perdoret gjate gjithë procesit te arbitrazhit.

Rogner GmbH

Robert Rogner, President

(Gjithesisht)

B. Baban



STATUTI

I

SHOQERISE "GOLDEN EAGLE" SHPK

KAPITULLI I

Emertimi, Forma Ligjore, Selia, Kohezgjatja

Neni 1. Emertimi i Shoqerise

- 1.1. Emertimi i Shoqerise ("Shoqeria") eshte "Golden Eagle". Ne te gjitha dokumentet, faturat, reklamat dhe publikimet e nxjerra nga Shoqeria, emri i saj do te pasohet nga:
- a. fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" apo "Ltd." (versioni Anglisht) ose "SHPK" (versioni ne Shqip i Ltd.),
 - b. selia.

Neni 2. Forma Ligjore e Shoqerise

- 2.1. Shoqeria Tregtare "Golden Eagle" shpk eshte person juridik shqiptar, i organizuar ligjesisht si nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar, ne perputhje me ligjet e Shqiperise, dhe dispozitat e statutit aktual apo atyre qe do vijojne.

Neni 3. Selia e Shoqerise

- 3.1. Selia e Shoqerise eshte ne Hotel Europapark, Bulevardi Dëshmoret e Kombit, Tirane, Shqiperi. Shoqeria rezervon te drejten te transferoje seline e saj ne nje adrese dhe/apo ne nje qytet tjeter te Shqiperise.

y

Neni 4. Kohezgjatja e Shoqerise

4.1. Kohezgjatja e Shoqerise eshte caktuar per 100 vjet nga data e krijimit te saj. Kohezgjatja mund te zgjatet me tej nepermjet nje vendimi unanim te ortakeve.

KAPITULLI II

Objekti i Shoqerise

Neni 5. Objekti i Shoqerise

5.1. Objekti kryesor i Shoqerise eshte te ndertoje dhe menaxhoje nje kompleks Hotelier-Tregtar ne Tirane, Shqiperi, i cili perfshin nje hotel dhe nje siperfaqe tregtare, me zyra, dyqane dhe apartamente. Objektet e tjera te Shoqerise perfshijne tregtine e eksport-importit, sikurse aktivite te tjera sherbimi, te lidhura me veprimtarine e Kompleksit Hotelier-Tregetar, si administrimi i Pasurive te Paluajtshme dhe veprimtarite e operatorit turistik.

Neni 6. Ndryshimet

6.1. Shoqeria rezervon te drejten per te ndryshuar objektin ne çdo kohe, ashtu si percaktohet ne statut.

KAPITULLI III

Kapitali themeltar; Pjeset e Kapitalit



Neni 7. Kapitali themeltar

7.1. Kapitali i Shoqerise eshte tete million e teteqind mije dollare amerikane (8,800,000.00 USD), i perbere nga tetemije e teteqind (8,800.00) pjese kapitali, me vlere nominale 1,000.00 USD (nje mije dollare amerikane) secila, plotesisht te nenshkuara dhe te emetuara.

Neni 8. Ortaket e Shoqerise dhe Pjeset e Kapitalit te zoteruara nga Ortaket

8.1. Ortaket e Shoqerise dhe pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre, vijojne si me poshte:

(a) FEWO Beteiligungs Verwaltung GmbH, shoqeri Austriake me pergjegjesi te kufizuar, me seli ne Nikolaigasse 22, A-9500,

y 
 2

Villach Austri, e cila zoteron gjashte mije e treqind (6,300) pjese kapitali me vlere nominale 1,000 USD (nje mije US dollare) secila ;

(b) BERZH (Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim), nje Organizate Nderkombetare me seli ne One Exchange Square, Londer EC2A 2JN, Mbretaria e Bashkuar, e cila zoteron nje mije e njeqind e njezet e kater (1,124) pjese kapitali me vlere nominale 1,000 USD (nje mije US dollare) secila ;

(c) Rogner International Hotels & Resorts GmbH, nje shoqeri austriake me pergjegjesi te kufizuar, me seli ne Breitenfurterstrasse 118, A-1230, Viene, Austri, e cila zoteron njemije e treqind e shtatedhjete e gjashte (1,376) pjese kapitali me vlere nominale 1,000 USD (nje mije US dollare) secila ;


Neni 9. Zvogelimi dhe Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

- 9.1. Kapitali themeltar mund te zvogelohet apo zmadhohet sipas Vendimeve te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Kapitullin IV te ketij Statuti dhe ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar.
- 9.2. Kapitali themeltar mund te zmadhohet me kontribut ne para ose ne natyre, si dhe me perfshirjen e rezervave apo fitimeve.

Neni 10. Te Drejtat dhe Detyrimet e Ortakeve

- 10.1. Ortaket jane vetem ata te cilet zoterojne pjese te kapitalit te Shoqerise.
- 10.2. Cdo pjese e kapitalit jep te drejten e nje vote ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve ("Asambleja e Pergjithshme"), te drejten per te zgjedhur apo per t'u zgjedhur ne organet drejtuese, te drejten per te marre pjese ne shperndarjen e fitimeve te shoqerise (sipas ketij statuti dhe dispozitave te tjera ligjore), apo te drejtave te tjera te percaktuara ne kete statut ;
- 10.3. Ortakeve, ne baze te kerkeses se tyre me shkrim, do t'u jepen, informacione dhe te dhena, ne lidhje me aktivitetin e shoqerise ne çdo kohe, duke perfshire edhe te drejten per te konsultuar librat dhe dokumentat e Shoqerise.
- 10.4. Detyrimet e Shoqerise jane te garantuara nepermjet kapitalit themeltar, dhe Ortaket mbajne pergjegjesi vetem per vleren e pjeseve te kapitalit qe ata

4



zoterojne; ortaket nuk kane pergjegjesi tjeter pervec pjeseve te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise (me perjashtim te garancive dhe kredive qe ata kane kontraktuar).

Neni 11. Transferimi i pjeseve te kapitalit social

- 11.1. Pjeset e kapitalit mund te transferohen lirisht ndermjet ortakeve sipas nenit 49, te Ligjit shqiptar Nr. 7638, i vitit 1992.
- 11.2. Pjeset e Kapitalit mund t'u transferohen personave te trete, te cilet nuk jane ortake, me miratimin e te gjithe ortakeve te tjere. Shoqeria dhe secili nga ortaket e tjere duhet te informohen, ne avance, mbi çmimin e propozuar te shitjes, nepermjet nje letre te derguar me poste te regjistruar, e cila duhet te permbaje te gjithe informacionin e nevojshem, veçanerisht cmimin e blerjes per çdo pjese te kapitalit. Ortaket duhet te aprovojne apo te refuzojne transferimin e propozuar, brenda tre muajve nga data e komunikimit. Nese Shoqeria nuk merr vendim brenda tre muajve, atehere transferimi konsiderohet i aprovuar. Ortaket, te cilet kane refuzuar shitjen e propozuar, duhet te blejne Pjeset e Kapitalit te ofruara, brenda tre (3) muajve, duke filluar nga dita e refuzimit, me çmimin qe pala e trete do te paguante, dhe ne proporcion me pjeset e kapitalit fillestar qe ata zoterojne;
- 11.3. Krijohet "Libri i Ortakeve", ne te cilin te gjithe Ortaket duhet te regjistrojne pjeset e kapitalit qe ata zoterojne ne Shoqeri. Ne menyre qe te konsiderohet ortak, cdo person i cili zoteron nje apo disa pjese te kapitalit te Shoqerise, duhet t'i regjistroje ato ne Librin e Ortakeve.
- 11.4. Cdo shenim ne liber duhet te permbaje emrin e Ortakut, numrin e pjeseve te kapitalit te zoteruar nga Ortaku, si dhe formen e transaksionit nepermjet te cilit eshte fituar pasuria. Libri mbahet nga Administratori Menaxhues (nese eshte zgjedhur, apo perndryshe nga Kryetari i Bordit te Administratoreve) i Shoqerise, i cili duhet te leshoje kopje te Librit, Ortakeve, nese ata e kerkojne. Cdo shenim ne Liber regjistrohet dhe nenshkruhet nga Administratori Menaxhues ose nga Kryetari, me paraqitjen nga ortaku i interesuar te dokumentit qe provon pronesine e pjeseve te kapitalit.


KAPITULLI IV

Asambleja e Pergjithshme.

Neni 12. Kompetencat

- 12.1. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi kontrollues i Shoqerise, i cili merr vendime mbi aktivitetin dhe politiken ekonomike dhe tregtare te saj.

4



12.2. Asambleja e Pergjithshme ka kompetencat e meposhtme:

- (a) aprovon strukturen organizative te Shoqerise dhe numrin e vendeve te punes ;
- (b) emerone dhe shkarkone anetaret e Bordit te Administratorve ;
- (c) merr vendime ne lidhje me adoptimin e Statutit ose modifikimin dhe ne lidhje me ndryshimin e formes ligjore te Shoqerise;
- (d) merr cdo vendim tjeter mbi ceshtje te tjera ne lidhje me Shoqerine, ashtu sic eshte parashikuar ne kete Statut dhe/ose nga ligjet e zbatueshme ne fuqi.

Neni 13. Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

- 13.1. Asambleja e Pergjithshme thirret nga Kryetari i Bordit te Administratorve (« Kryetari ») ose nga njeri prej Administratorve mbi bazen e nje mandati te dhene nga Kryetari. Kryetari gjithsesi mundet te delegoje kete tages te Administratori Menaxhues.
- 13.2. Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme mbahen te pakten nje here ne vit, duke respektuar daten dhe periudhen ne perputhje me ligjin shqiptar, me qellimin per te analizuar bilancin vjetor, fitimet dhe humbjet financiare te vitit te kaluar dhe per te vendosur mbi programin dhe buxhetin e vitit te aktual.
- 13.3. Per me teper, Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme thirren me (1) kerkesen e Ortakeve qe perfaqesojne te pakten nje te dhjeten (1/10) e kapitalit social, (2) me kerkesen te eksperteve - kontabel ose (3) kur kapitali social zvogelohet me shume se 50% si rezultat i humbjeve ose ne raste te tjera te cilat jane te parashikuara nga ligji i zbatueshem ne fuqi.
- 13.4. Njoftimet per cdo mbledhje te Asamblese duhet t'u dergohen Ortakeve me poste te regjistruar, telefax, teletex ose e-mail, ne adresat e dhena nga Ortaket ne Librin e Shoqerise te pakte 15 dite perpara dates se mbledhjes. Njoftimi duhet te percaktojte daten, vendin dhe rendin e dites se Asamblese se Pergjithshme. Cdo Mbledhje e Asamblese se Pergjithshme e thirrur ne menyre te parregullt, mund te anulohet me ane te kerkeses se njerit prej Ortakeve. Megjithate, nese te gjithe Ortaket jane te perfaqesuar ne Mbledhje dhe bien dakort, Mbledhja mund te vazhdoje.
- 13.5. Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve zhvillohet ne seline e Shoqerise, ose ne ndonje vend tjeter, si te jete vendosur.
- 13.6. Ne Mbledhjen e Ortakeve, Ortaku mund te votoje personalisht ose me prokure te shkruar, e cila i leshohet cdo pale te trete ose cdo Ortaku tjeter.
- 13.7. Neni 57 i Ligjit Shqiptar nr 7638 i vitit 1992, i cili parashikon se vendimet e ortakeve mund te merren me konsultim me shkrim (Vendim Qarkullues), do te zbatohet si me poshte. Vendimet e propozuara do te qarkullojne ne forme te shkruar mes te gjithe Ortakeve me fax, telex, e-mail ose poste te regjistruar. Vendime te tilla do te konsiderohen te miratuara nese a) rendi i dites eshte aprovuar nga te gjithe ortaket me shkrim, dhe b) konsultimet e shkruara te

y 5
 5
 5

ortakeve arrijne kuorumin e votave ashtu sic kerkohet ne kete statut. Secilit ortak do t'i kerkohet te transmetoje votimin e tij me shkrim tek Administratori Menaxhues, nese ai eshte zgjedhur, ose per ndryshe tek Kryetari, me fax, e-mail, telex, poste te regjistruar. Ky votim duhet te jete i shprehur qarte dhe i pa kushtezuar dhe duhet te percaktoje qarte nese vota eshte ne favor apo kunder vendimit. Administratori Menaxhues ose Kryetari do te mbledhin aprovimet ose refuzimet dhe do te komunikojne rezultatin e konsultimit. Cdo administrator dhe/ose ortak i Shoqerise gezon te drejten te kontrolloje cdo dokument qe ka lidhje me Vendimin Qarkullues.

Meni 14. Kompetencat e vecanta te Asamblese se Pergjithshme

- 14.1. Jane ne kompetencen e vetme te Asamblese se Pergjithshme dhe nuk mund t'i delegohen Bordit te Administratoreve:
- (a) ndryshimet dhe/ose amendimet e Statutit dhe/ose Aktit te Themelimit te Shoqerise;
 - (b) riorganizimi i Shoqerise, prishja apo likuidimi i saj;
 - (c) rregullat baze sipas te cilave Shoqeria zhvillon biznesin e saj;
 - (d) rritja dhe /ose zvogelimi i kapitalit social;
 - (e) miratimi i bilancit, humbjeve dhe fitimeve, raportit te ekspertit kontabel, bilancit te likuidimit dhe te gjitha raportet financiare te Shoqerise;
 - (f) mbulimi i humbjeve;
 - (g) te gjitha vendimet qe kane lidhje me fondet e detyrueshme dhe vullnetare te Shoqerise;
 - (h) leshimi i fatures se kontributit te ortakut ne kapitalin social dhe i certifikates se interesave te tyre;
 - (i) themelimi i degeve, filialeve dhe zyrave shtese te Shoqerise, ashtu si edhe pjesemarrjen ne subjekte te tjera;
 - (j) te gjitha vendimet qe kane te bejne me huamarrje qe do te kontraktohen nga Shoqeria pervec kredive normale tregetare te zbatueshme ne veprimtarine e Kompleksit Tregataro-Hotelier ;
 - (k) pagesa dhe / ose kompensimi i Administratoreve;
 - (l) te lidhe Marreveshje te Pergjithshme Kontraktore (General Contractor's agreement) ne emer te Shoqerise;
 - (m) lidhjen e kontratave te menaxhimit te hotelit dhe/ose zyrave;
 - (n) ndermarrjen e aktiviteteve te bizneseve te reja dhe/ose zhvillimeve te reja;
 - (o) dhenien e hipotekave, pengjeve ose mjeteve siguruese te ngjashme.
 - (p) blerjen e pasurive te paluajteshme;
 - (q) blerjen e pjeseve te kapitalit te shoqerive te tjera;

26

M

6

14.2 Ne lidhje me listen e nenit 14.1 nga pika a) deri te q), te gjitha vendimet duhet te merren unanimisht nga ortaket qe perfaqesojne te gjitha pjeset e kapitalit me te drejte vote.


14.3 Te gjitha vendimet e tjera te Asamblese se Pergjithshme merren me shumice te zakonshme sipas dispozitave te vecanta te ketij Statuti si dhe te Legjislacionit ne fuqi.

14.4 Ne rast se kuorumi i kerkuar, ashtu sic percaktohet ne kete statut (numri i votave dhe/ose numri i ortakeve te perfaqesuar) ne lidhje me ceshtje, mbi te cilat duhet vendosur, nuk eshte i mundur te arrihet, ceshtja duhet rivotuar ne nje mbledhje te dyte ose nepermjet konsultimeve me shkrim, dhe ne rast se deshton perseri arritja e kuorunit ne mbledhjen e dyte sic kerkohet nga ky Statut, atehere ceshtja do te vendoset nga arbitrazhi, ashtu sic percaktohet nga Neni 27 i ketij Statuti.

Neni 15. Organizimi i Asamblese se Pergjithshme

15.1 Me perjashtim te rasteve te parashikuara ne nenin 14 te ketij statuti per te cilat kerkohet miratimi me vota unanime te te gjitha ortakeve qe perfaqesojne te gjitha pjeset e kapitalit me te drejte vote, ne rastet e tjera:

- a) Asambleja e Pergjithshme ka nje kuorum te vlefshem per te marre vendime, ne qofte se ne Mbledhje jane prezent ortaket ose perfaqesuesit e tyre qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e te gjitha pjeseve te Kapitalit Social;
- b) Ne cdo Mbledhje te pare me kuorum te vlefshem te Asamblese se Pergjithshme, vendimi aprovohet nese votohet nga shumica e ortakeve qe perfaqesojne te pakten me shume se gjysmen e pjeseve te Kapitalit Social.
- c) Nese ne Mbledhjen e pare te Asamblese se Pergjithshme kuorumi i kerkuar i perfaqesimit te ortakeve sipas nenit 15.1 a) dhe/ose kuorumi i kerkuar i votave sipas nenit 15.1 b) nuk eshte plotesuar, vendimi merret ne shqyrtim nga nje Mbledhje e Dyte e Asamblese se Pergjithshme ose me Vendim Qarkullues ('Mbledhja e Dyte'). Kryetari (ose Administratori Menaxhues) duhet te njoftojne Mbledhjen e Dyte ose Vendimin Qarkullues tek te gjitha Ortaket.
- d) Ne Mbledhjen e Dyte, Vendimet miratohen ose refuzohen me shumicen e thjeshte (i) te Ortakeve prezent ose te perfaqesues ne Mbledhje ose (ii) te Ortakeve qe i jane pergjigjur Vendimit Qarkullues brenda afateve te vendosura nga Kryetari (ose Administratori Menaxhues).



- 15.2. Asambleja e Pergjithshme drejtohet nga Kryetari, i cili duhet te jete Administratori Menaxhues dhe ne mungese te tij, nje nga Administratoret, i emeruar nga Administratori Menaxhues, me perjashtim te rastit kur Asambleja e Pergjithshme vendos te emeruje nje person tjeter si Kryetar.
- 15.3. Kryetari emerion nje prej antareve te Asamblese se Pergjithshme si Sekretar, i cili duhet te hartoje Proces – Verbalin e Mbledhjes.
- 15.4. Proces-verbali i shkruar depozitohet ne Librin e Shoqerise. Ai do te nenshkruset nga personi qe ka drejtuar Mbledhjen dhe nga Sekretari qe e ka hartuar ate.

Neni 16. E drejta e votes ne Asamblene e Pergjithshme

- 16.1. Vendimet merren me me votim te hapur dhe sipas kushteve te percaktuara ne nenet 14 dhe 15 te ketij statuti. Kerkesa per te konfirmuar voten ne menyre te shkruar, mund te behet nga cdo ortak.
- 16.2. Me kerkesen e personit drejtues ose te nje grupi ortakesh te pranishem ose te perfaqesuar dhe te cilet, perfaqesojne te pakten nje te dhjeten e pjeseve te Kapitalit social, vota duhet te jete sekret.
- 16.3. Ortaket mund te caktojne ne forme te shkruar nje person te trete per t'i perfaqesuar ata ne Asamblene e Pergjithshme. Numri i votave te secilit prej ortakeve ose te perfaqesuesve te tyre percaktohet nga numri i pjeseve qe Ortaket zoterojne ne Kapitalin e Shoqerise.

KAPITULLI V

Bordi i Administratoreve

Neni 17. Organizimi

- 17.1. Shoqeria administrohet nga nje Bord Administratoresh i perbere nga tre anetare te emeruar me vendim te ortakeve. Ortaket mund te emerujne gjithashtu midis administratoreve nje Administrator Menaxhues. Ne kete rast Administratori Menaxhues administron aktivitetin e Shoqerise dhe vepron ne emer te Shoqerise, me perjashtim te rasteve ku ky statut kerkon nje vendim unanim te te gjitha administratoreve.
- 17.2. Administratoret mund te jene te cdo nenshtetesisie dhe nuk kane nevojte te jene rezidente ne Shqiperi. Ata zgjidhen per nje vit, me te drejte rizgjedhjeje.

y J 8
K

17.3. Administratoret emerojne midis tyre Kryetarin e Shoqerise. Kryetari zgjidhet per nje vit me te drejte rizgjedhjeje.

17.4. Mbledhjet e Bordit mblidhen me kerkese te cdo Adminstratori nga Kryetari i cili duhet te vendose oren dhe vendin e takimit. Kryetari mund te delegoj kete detyre tek Administratori menaxhues. Mbledhjet mund te mbahen brenda ose jashte Shqiperise. Lajmerimi per Mbledhjet e Bordit duhet bere te pakten 10 dite perpara, me shkrim, dorezuar personalisht ne dore ose dergohet me fax, email ose me poste ne adresen e punes se secilit prej Administratoreve.

17.5. Cdo veprim i kerkuar ose i lejuar per t'u marre nga Bordi i Administratoreve ne Mbledhjen e bordit, mund te merret edhe pa Mbledhje, me ane te konsultimit me shkrim. Vendimet e propozuara do te qarkullojne me shkrim ndermjet te gjithë Administratoreve me fax, e-mail, telex ose me poste te regjistruar dhe keto Vendime do te quhen te miratuara nese vendimet e shkruara nga Administratoret arrijne kuorumin e votave te kerkuar nga ky statut. Secili nga Administratoret duhet te transmetoje votimin e tij te shkruar tek Administratori Menaxhues nese eshte i caktuar ose ndryshe tek Kryetari me fax, e-mail, ose telex i konfirmuar me poste te regjistruar. Ky votim duhet te shprehet qarte dhe pa kushte dhe duhet te shpalle qarte nese votuesi eshte ne favor ose kundra vendimit te vecante. Administratori Menaxhues (ose Kryetari) do te mbledhe miratimet ose refuzimet dhe do te komunikojë rezultatin e konsultimit. Cdo Administrator dhe Ortak i Shoqerise ka te drejte te kontrolloje dokumentacionin ne lidhje me cdo konsultim te shkruar.

Neni 18. Votimi


18.1. Cdo Administrator ka te drejten e nje vote.

18.2. Vendimet apo veprimet e meposhtme te Bordit te Administratoreve merren ne menyre te vlefshme vetem me konsensusin unanim te te gjithë Administratoreve:

(a) procedimet ligjore te cdo lloji ose natyre;

(b) ndertimi i objekteve te reja ne pronen e marre me qira ose ndryshimet e kesaj prone ose kthimi i prones;

(c) cdo amandament, ndryshim, alternim, perfundim, ose cdo heqje dore nga te drejtat, e cdo marreveshjeje te kontraktoreve te pergjithshem, e marreveshjeve te menaxhimit te hoteleve dhe /ose zyrove, marreveshjeje kredie, kontrate qeraje ose kontrata hipoteke, pengu apo garanci te tjera te tilla.

4
9


- 18.3 Te gjitha vendimet ose veprimet e tjera te Bordit te Administratoreve merrem me shumice votash te thjeshte.
- 18.4 Ne raste se konsensusi unanim apo shumica e kerkuar nuk plotesohet, dhe kjo situatë vazhdon edhe ne takimin tjetër te Bordit dhe/ose konsultimit te shkruar, ceshtja i dergohet Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

Neni 19. Shkarkimi

- 19.1. Përveç shkarkimit me shkak te parashikuar ne ligjin shqiptar, Administratoret mund te shkarkohen me ose pa shkak me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

KAPITULLI VI

Administrimi financiar i Shoqerise

Neni 20. Ekspertet kontabel te autorizuar

- 20.1. Ortaket duhet te emerojne eksperte kontabel te autorizuar ne numrin dhe per kohezgjatjen e percaktuar nga ligji shqiptar.
- 20.2. Ekspertet kontabel te autorizuar kryejne funksionet e kontrollit financiar ne perputhje me ligjin Shqiptar.

KAPITULLI VII

Aktiviteti i Shoqerise

Neni 21. Viti financiar

- 21.1. Viti financiar fillon ne ditën e pare te Janarit dhe mbaron me 31 Dhjetor per cdo vite. Viti i pare financiar fillon ne ditën e pare qe eshte themeluar Shoqeria.



Neni 22. Stafi i Shoqeries

22.1. Stafi menaxhues duhet te aprovohet nga Bordi i Administratoreve. Pagat, tatimi mbi te ardhurat dhe kontributet e sigurimeve shoqerore do te mbahen sipas ligjeve ne Shqiperi.

Neni 23. Mbajtja e llogarive

23.1. Shoqeria mban financat ne lek dhe ne monedhe te huaj dhe mban bilancin dhe dhe llogarite ne perputhje me ligjin ne Shqiperi. Per me teper, nese kerkohet nga marreveshjet e huase me bankat interacionale ose marreveshje te tjera te lidhura nga Golden Eagle ShPK, Shoqeria do te paraqese rezultatet financiare ne perputhje me standartet gjithesisht te pranuar te auditimit, sic kerkohet ne keto marreveshje.

Neni 24. Llogaritja e Fitimit dhe Shperndarja

- 24.1 Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te bilancit te aprovuar nga Asambleja e Pergjithshme. Shperndarja do te percaktohet nga Asambleja e Pergjithshme. Ortaket me kombesi te huaj gezojne te drejten te konvertojne fitimin e tyre ne monedhe te huaj dhe te trasferojn fitimin jashte Shqiperise ne perputhje me kushtet e ligjit shqiptar per investitoret e huaj.
- 24.2. Nga fitimi vjetor, do te mbahet fondi rezerve ne perputhje me ligjin shqiptar per fondet rezerve te detyrueshme.

KAPITULLI VIII

Ndryshimi i formes ligjore, shperndarja

Neni 25. Ndryshimi i formes ligjore

- 25.1. Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshohet ne vendim te Asamblese se Pergjitheshme si ne nenin 14 dhe ne perputhje me kushtet perkatese te ligjit ne Shqiperi.
- 25.2. Shoqeria e re do te kryeje te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit kerkuar ne Shqiperi.



Neni 26. Shperndarja e Shoqerise

26.1 Shoqeria mund te shperndahet ne keto raste:

(a) vendim i marre nga Asambleja e Pergjithshme sic percaktohet ne nenin 14 dhe 15;

b) humbja e gjysmes se kapitalit social, pasi fondi rezerve te jete shpenzuar, me perjashtin te rastit kur Asambleja e Pergjithshme vendos te plotesoje kapitalin social ose vendos ta zvogeloje ate sipas ligjit shqiptar.

26.2. Ne rast shperndarjeje Shoqeria do te likuidohet; nje ose me shume Likuidatore caktohen nga Asambleja e Pergjithshme.

26.3. Asetet qe rezultojne nga likuidimi duhet se pari te perdoren per te paguar kreditoret e privilegjuar (pagat, te drejta te tjera te stafit, taksat dhe detyrimet, kontributet e sigurimeve shoqerore, kredite dhe interesat, etj) dhe me pas kreditoret e tjere, duke pershire dhe huate e dhena nga Ortaket e Shoqerise. Me pas, pjesa e mbetur duhet t'iu ndahet ortakeve sipas perqindjes se kapitalit social qe ata kane ne pronesi.

26.4. Ne rast shperndarjeje te Shoqerise, Partneret me kombesi te huaj gezojne te drejten te konvertojne ne monedhe te huaj dhe te transferojne jashte Shqiperise pa kufizime, te gjitha pasurit e tyre te fituara nga likuidimi i Shoqerise, sipas ligjit shqiptar per investitoret e huaj.

KAPITULLI IX

Te ndryshme

Neni 27. Arbitrazhi

27.1. Cdo mosmarreveshje, kundertshti ose pretendim, midis Shoqerise dhe nje ose me shume Ortakeve te huaj, qe rrjedh ose ne lidhje me kete statut ose shkeljen, perfundimin ose pavlefshmerine e tij, duhet te referohet dhe perfundimisht te zgjidhet nepermjet arbitrazhit ne perputhje me rregullat e Arbitrazhit UNCITRAL, ne fuqi ne daten e kesaj marreveshjeje. Arbitri dhe autoriteti kompetent per emerimin, ne lidhje me rregullat e UNCITRAL, eshte Gjykata Londineze e Arbitrazhit Nderkombetar. Ne rastet kur rregullat e Arbitrazhit te UNCITRAL nuk parashikojne nje situate te vecante, Arbitri duhet, me pushtetin e tij absolut, te vendose se cfare rruge duhet te ndiqet dhe Vendimi i Arbitrit eshte perfundimtar. Vendi i arbitrazhit do te jete Londra ose Tirana, sipas zgjedhjes se pales qe ngre pretendimet. Gjuha angleze duhet te perdoret gjate gjithe procesit te arbitrazhit.

CERTIFIKATE

Nigel Karter Nen/sekretar I Pergjithshem i Bankes Eoropiane per Rindertim dhe per Zhvillim (Banka), deklaroi si me poshte :

(a) Neni 30 paragrafi 4 i Marreveshjes qe Themelon Banken (Marreveshja) thote :

“Presidenti do te jete perfaqesuesi ligjor I Bankes”

(b) Sipas nje Urdhri Administrative te dates 3 tetor 1994 me titull “ Nenshkrimi I Instrumentave ne Forme te Shkruar : Per Caktimin e Zyrtareve “, ndryshuar nga kjo date (Urdheri Administrativ) , nenshkruar nga Presidenti ne baze te nenit 30, paragrafi 4 te Marreveshjes keta qe vijojne : Zevendes Presidenti i Pare I Bankes, Departamenti i Veprimeve Bankare, Nen/Zevendes Presidenti, Departamenti i Veprimeve Bankare, Nen/ Zevendes Presidenti, Zevendes Presidenca e Finances , dhe cdo Drejtor I Grupit te Bisnesit , Departamenti I Veprimeve Bankare , Drejtoret e Grupeve te Punes , Departamenti I Veprimeve Bankare ose Nen/drejtoret e Grupeve te Punes, Departamenti I Veprimeve Bankare mund te nenshkruajne dokumentat e permendura ne pikat (1), (2), (3), (4):

- (1) Marreveshjet dhe instrumentata me ane te cilave banka mer persiper te jape hua , investime nepermjet kapitaleve private , angazhime garancie dhe sigurimi apo per te marre persiper operacione te ngjashme , duke perfshire marreveshje huaje , marreveshje abonimi, marreveshje per blerje aksionesh dhe te pritshme.
 - (2) Marreveshjet dhe instrumentat qe do te ekzekutohen perpara dhe ne zbatim te marreveshjeve te permendura ne piken 1 , duke perfshire leter mandatet , nderrmarjet konfidenciale , marreveshjet e agjensise, zbatimin e tyre ose marreveshjet e bashke financimit, marreveshjet per projekte , marreveshje apo intrumente qe japin garanci apo siguri ne favor te Bankes , marreveshjet e ndarjes se sigurimit , marreveshjet ndermjet kreditoreve , marreveshjet qe kane te bejne me tjetersimin e aseteteve mbi te cilat Banka ka nje interes sigurimi, marreveshjet per fondet e financimit te projekteve , marreveshje per perfundimin apo mbeshtetjen e projekteve, marreveshje menazhimi, marreveshje pjesemarrjeje, kalim huaje apo marreveshjet e e zevendesimit te kontrates ekzistuese, marreveshje per trajtimin e aksioneve ne treg dhe marreveshjet e terheqjes se kapitaleve
 - (3) Shtesat ndryshimet njoftimet kerkesat dhe te rejat mbi marreveshtjet dhe instrumentat sipas pikave 1 ose 2 , perfshire njoftimet per rishikimin e grafikut te amortizimit , njoftimet e pezullimit apo shuarjes, njoftimet e heqjes dore apo pelqimit , njoftimet e mospermbushjes dhe njoftimet e persheptimit.
 - (4) Prokurat per kezekutimin e dokumentave sipas pikes 1 ose 2 ose 3 ; prokurat per mbledhjet e aksionereve dhe kreditoreve ; marreveshjet e shperblimit ndermjet Bankes dhe te caktuarve prej saj te cilat veprojne si drejtor te kompanive net e cilat eshte kryer investimi.
- (c) Caktojne Mary Ellen Collins si Drejtore te Grupi te Punes , Departamenti I Rimekembjes Financiare ne Banke.

- (d) Bashkalidhur eshte nje kopje origjinale e aktit te Autorizimit per nenshkrimin qe mban daten 29 nentor 2004 , nenshkuar nga Mary Ellen Collins ne vijim te urdherit administrativ , sipas te cilit Murat Yildiran Drejtor i Zyres se Tiranes dhe Donald Mishaxhi analist karriere ne zyren rezidente ne Tirane, jane autorizuar individualisht te nenshkruaje per dhe ne emer te Bankes cdo dhe te gjitha instrumentat ne forme te shkruar ne te cilat referohet ketu.

Nenshkuar dhe vulosur me vulen e bankes me daten 29 nentor 2004 ne Londer

(nenshkrimi)

Nigel Carter

Nen/sekratar I Pergjithshem



**VENDIM I ROGNER GmbH, ORTAKU I VETEM DHE THEMELUES I
GOLDEN EAGLE SHPK (SHQIPONJA E ARTE)**

ATIJ QE I PERKET

Une, Robert Rogner, qe veproj si President dhe perfaqesues i ligjshem i Shoqerise austriake Rogner GmbH, Widmangasse 43, A-9500 Villach, Austri, qe jam themelues dhe ortak i vetem i Shqiponja e Arte Shpk (Golden Eagle Shpk) shoqeri shqiptare e regjistruar ne Gjykatën e Rrethit te Tiranes me 5 Qershor 1993 me numer 3709/1, ketu me poshte vertetoj qe kam vendosur te ndryshoj nenet e meposhteme te Statutit te Shqiponja e arte Shpk:

Neni 1, Neni 3, Neni 4, Neni 5, Neni 7, Neni8, Neni 9, Neni 11, Neni 12, Neni 13, Neni14, Neni 17, Neni18, Neni 19, Neni 20, Neni 23, Neni 25 dhe Neni 27.

Versioni i ri i Neneve te ndryshuara te Statutit do te lexohet siç eshte vendosur ne Shtojcen Nr.1 bashkelidhu ketij Vendimi te Themeluesit dhe e nenshkruar nga Une vete.

Viene 13 Korrik 1994

Rogner GmbH
Robert Rogner, President

Perkthyes:
(B.Babari)

10

Z. R. Panajoti
25 SHTATOR 2006
KERKESE



KERKUES :

Shoqeria "Shqiponja e Arte" sh.p.k. ("Golden Eagle shpk"), perfaqesuar nga Administratori i saj z. Klaus Ressimann.

Coef depozitimit u bashkë + detyrues

Objekti: bashkë e bashkë

zff Angler + shpif

*Prokur. # u 4893/1732
@ + 17-8-2006*

*Q. Ankorzon 17-8-2006
u 6387 Reg. M. Saduku,
Kontakti gjyqësor u 7476*

*Reg. 16/11/2006 M. Saduku
- vepshim 19/7/2005
u 4895 Reg. A. Mollaku,
4896 Reg.*

*- Gjerëshes, prokur
3-8-2006 4894 Reg
A. Mollaku*

*- Prokur 5946/2187
M. Saduku*

OBJEKTI :

Kerkohet depozitimi ne Regjistrin Tregtar i:

a. Vendimit te Asamblese se Pergjithshme te ortakeve te shoqerise Golden Eagle shpk, date 17 Gusht 2006, per miratimin e ndryshimeve ne statutin e shoqerise "Golden Eagle shpk";

b. Ndryshimit te emertimit te shoqerise nga "Shqiponja e Arte shpk" ne "Golden Eagle shpk".

BAZA LIGJORE :

Ligji Nr. 7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare, Ligji Nr. 7667 date 28.01.1993 "Per Regjistrin tregtar".

PERPARA


Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane

Tirane 6 / 09 / 2006



Golden Eagle S.h.P.K., Reg. No.: 3709/1,
Bvd. Dëshmorët e Kombit, AL-Tirana,
Tel: 00355/42/35 035,
Fax: 00355/42/35 030.

Handwritten signatures and notes on the right side of the document, including names like 'Klaus Ressimann' and dates like '17/8/2006'.



Shoqeria "Shqiponja e Arte" sh.p.k. ("Golden Eagle" sh.p.k.) është person juridik, i regjistruar me Vendim Nr.3709, date 27.04.1992 dhe ri-regjistruar ne date 05.06.1993 me Vendimin Nr.3709/1, me:

- Ortake
- (1) FEWO Beteiligungs Verwaltung GmbH, mbajtese e 6300 pjese kapitali.
 - (2) Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim BERZH, mbajtese e 1124 pjese kapitali.
 - (3) Rogner International Hotels & Resorts GmbH, mbajtese e 1376 pjeseve kapitali, mbajtese e 1376 pjeseve kapitali.

-Kapital themeltar është 8.800.000 USD i ndare ne 8 800 pjese me nje vlere nimonale prej 1 000 USD secila.

- Seli: Hotel Rogner EuropaPark" Bvd. Deshmoret e Kombit, Tirana, Shqiperi.

-Bordi i Administratoreve perbehet nga: Z. Robert Rogner jun, Z. Klaus Ressmann, Z. Gerhard Stranner.

MEQENESE:

Ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme te ortakeve te shoqerise Golden Eagle shpk, date 17 Gusht 2006, Nr. 4899 Rep, Nr. 1732 Kol, te mbajtur ne Tirane, ku ishin te perfaqesuar rregullisht 3 ortaket e shoqerise qe perfaqesonin edhe 100% te kapitalit te saj, (1) FEWO Beteiligungs Verwaltung GmbH, mbajtese e 6 300 pjeseve te kapitalit me vlere nominale 1 000 USD secila e perfaqesuar nga Administratori Robert Rogner (2) Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim BERZH, mbajtese e 1124 pjeseve te kapitalit me vlere nominale 1 000 USD secila, perfaqesuar me prokure te posaçme nga zoti Murat Yildiran dhe (3) Rogner International Hotels & Resorts GmbH mbajtese e 1376 pjeseve te kapitalit me vlere nominale 1 000 USD secila, perfaqesuar me prokure te posaçme nga Flonia Boriçi, u vendos:

Hotel Europapark

Golden Eagle S.h.P.K., Reg. No.: 3709/1,
Bvd. Deshmoret e Kombit, AL-Tirana,
Tel.: 00355/42/35 035,
Fax: 00355/42/35 050,



- Miratimi i ndryshimeve dhe amendimeve te statutit te Golden Eagle shpk. Statuti me ndryshimet dhe amendimet, mbi te cilat eshte rene dakort dhe jane firmosur rregullisht nga Ortaket, i bashkelidhet ketij Vendimi te ortakeve dhe konsiderohet pjese e pandare e tij.
- Ndryshimi i emertimit te shoqerise nga " Shqiponja e Arte shpk " ne " Golden Eagle shpk".
- Zoti Klaus Ressmann ne cilesine e Administratorit te Golden Eagle shpk autorizohet te ekzekutoje dhe dorezoje ne emer dhe per llogari te shoqerise cdo dokument te nevojshem per te zbatuar ketre vendim, duke perfshire por duke mos u kufizuar ne depozitim e ketij vendimi dhe regjistrimin e statutit te ndryshuar dhe te amenduar ne Rregjistrin Tregtar te gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane si dhe prane cdo autoriteti tjeter shqiptar, ashtu sic kerkohet nga legjislacioni shqiptar.

Ne baze te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite Tregtare" dhe Ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 " Per Regjistrin tregtar",

Kerkohet:

- Te pasqyrohet sa me siper ne Regjistrin Tregtar.
- Te depozitohet Vendimi i Asamblese se Pergjithshme te ortakeve te shoqerise "Golden Eagle shpk", date 17 Gusht 2006, Nr. 4899 Rep, Nr. 1732 Kol, per miratimin e ndryshimeve te statutit te "Golden Eagle shpk" dhe per ndryshimin e emertimit te shoqerise nga "Shqiponja e Arte shpk" ne "Golden Eagle shpk" si dhe dokumentat e tjera shoqeruese.

Golden Eagle shpk

Administrator


Klaus Ressmann


ROGNER
TIRANA
Hotel Europapark

Golden Eagle S.h.P.K., Reg. No.: 3709/1,
Bvd. Deshmoret e Kombit, AL-Tirana,
Tel.: 00355/42/35 035,
Fax: 00355/42/35 050.

PULLE TAKSE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 5765 REP NR 2244 KOL
Notere



VERTETIM

Ne Tirane, sot me daten 06.09.2006, para meje Noteres Or Fouadria anetare e Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht shtetasi Klaus Ressmann, lindur me 10 June 1941, nenshtetas austriak, me adrese ne Duerergasse 15, A-1060 Viene, Austri, mbajtes i pasaportes J 0555123 3, ne cilesine e Administratorit (Drejtor ekzekutiv) i «Golden Eagle sh.p.k.», madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta, i cili me vullnet te lire e te plote deklaroi se sa me sipër është kerkese drejtuar gjykates se Tiranës per depozitim e vendimit te mbledhjes se asamblese se kesaj shoqerie date 17 Gusht 2006 e perpiluar jashte kesaj zyre noteriale, te cilen e ka nenshkruar ne pranine time, dhe une noterja, pasi e gjej ne perputhje me ligjin 7638 „Per shoqerite tregtare“ date 19.11.1992, e vertetoj ate sipas ligjit.

EVISA SHEHAJ
PERKTHYESE
FRANSHIZOR
Tel. 0692291751



NOTERE

NOTERE
Mimoza Sadushaj
TIRANE

NOTER
KONNEK
FRANSHIZOR
Klaus R. Rappaport

Golden Eagle sh.p.k. Reg. No. 3709/1,
Lvd. Dëshmorët e Kombit, AL-Tirana,
Tel. 0035542/35 035,
Fax: 0035542/35 050.

Flonia Boriçi

Entela Memishaj

Zaka, Kosta & Tashko

Law Firm

Sky Tower, 141

00 355 4 221 666 ext. 174

**Liste e dokumentave
bashkangjitur
kerkeses se shoqerise "Golden Eagle" shpk**

Sot me daten 3 / 10 / 2006, para gjyqtares se Rrethit Gjyqesor Tirane, Regleta Panajoti , u paraqit kerkesa per te depozituar ne Regjistrin Tregtar :


- a. Vendimin e Asamblese se Pergjithshme te ortakeve te shoqerise "Golden Eagle" shpk, date 17 Gusht 2006, per miratimin e ndryshimeve ne statutin e shoqerise "Golden Eagle" shpk;
- b. Ndryshimin e emertimit te shoqerise nga "Shqiponja e Arte shpk" ne "Golden Eagle shpk".

Dokumentat bashkangjitur qe shoqerojne kete kerkesa jane:


1. Vendimi i Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve te Shoqerise "Golden Eagle" shpk, nr. 4899 Rep, Nr. 1732 Kol, date 17.08.2006.
2. Statuti i shoqerise "Golden Eagle" shpk, me ndryshimet dhe amendimet, pjese perberese e Vendimit te Asamblese.

3. Ekstrakt nga Rregjistri Tregtar i gjykates se Vienes, Austri, per shoqerine Rogner International Hotels & Resorts GmbH (ortake e "Golden Eagle" shpk), date 19.07.2006.
4. Ekstrakt nga Rregjistri Tregtar i gjykates se Klagenfurt, Austri per shoqerine FEWO Beteiligungs Verwaltung GmbH (ortake e "Golden Eagle" shpk), date 19.07.2006.
5. Prokure e leshuar nga BERZH (ortake e "Golden Eagle" shpk) per Murat Yildiran dhe Klajd Hasimi, si perfaqesues te saj ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve te Shoqerise "Golden Eagle" te mbajtur ne date 17.08.2006, te autorizuar per te votuar mbi pikat e rendit te dites.
6. Prokure e leshuar nga Rogner International Hotels & Resorts GmbH (ortak i "Golden Eagle" shpk), perfaqesuar nga administratori Robert Rogner Jun, per Flonia Boriçin si perfaqesuese e kesaj shoqerie ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve te Shoqerise "Golden Eagle" te mbajtur ne date 17.08.2006, e autorizuar per te votuar mbi pikat e rendit te dites.
7. Autorizim i leshuar nga Klauss Ressmann, ne cilesine e administratorit te shoqerise "Golden Eagle" shpk, me date 17.08.2006, me ane te te cilit autorizohet Flonia Boriçi dhe/ose Entela Memishaj te perfaqesojne kete shoqeri ne procedurat perpara rregjistrimit tregtar.

Av. Flonia Boriçi



Av. Entela Memishaj





**VENDIM I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ORTAKEVE
TE SHOQERISE
GOLDEN EAGLE SHPK**

Sot me 17 te muajit gusht, viti 2006, ne oren 15:00, perpara meje Noteres Arjana Mallkuci, ne Hotel Rogner EuropaPark, Bvd. Deshmoret e Kombit, Tirane, Shqiperi, u mbajt Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve (referuar me poshte si "Asambleja e Pergjithshme") e shoqerise Golden Eagle SHPK.

Moren pjese ne Mbledhje:

1. **FEWO Beteiligungs Verwaltung GmbH**, nje shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar Austriake me Seli ne Nikolaigasse 22, A-9500 Villach, Austria, mbajtese e gjashte mije e treqind (6,300,00) Pjeseve te Kapitalit me vlere nominale 1.000 USD (njemije dollare amerikane) secila, e perfaqesuar nga Administratori i shoqerise **Z. Robert Rogner**.
2. **BERZH (Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim)**, nje Organizate Nderkombetare me Seli ne One Exchange Square, London EC2A 2JN, Mbreteria e Bashkuar, mbajtese e njemije e njqind e njezet e kater (1,124,00) Pjeseve te kapitalit me Vlere Nominale 1.000 USD (nje mije dollare amerikane) secila, perfaqesuar nga **Z. Murat Yildiran**, mbajtes i Prokures se Posacme date 03.08.2006, Ref: 30361, bashkelidhur ketij dokumenti;
3. **Rogner International Hotels & Resorts GmbH**, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar Austriake, me Seli ne Breitenfurterstrasse 118, A-1230 Vienna, Austria, mbajtese e njemije e treqind e shtatedhete e gjashte (1,376,00) Pjeseve te Kapitalit me nje vlere nominale prej 1.000 USD (njemije dollare amerikane) secila, perfaqesuar nga **Znj. Flonja Borici**, mbajtese e Prokures se Posacme 5946 Rep. 2187 Kol., date 02.08.2006, bashkelidhur ketij dokumenti;

Kompetencat nenshkruese te perfaqesuesve te autorizuar te Ortakeve te Golden Eagle SHPK u verifikuan ne menyre te rregullt dhe te tere perfaqesuesit kane mandat te plote per te vepruar ne emer dhe per llogari te secilit Ortak ne Asamblene e Pergjithshme te Golden Eagle SHPK.

Z. Robert Rogner eshte zgjedhur Kryetar i Asamblese se Pergjithshme dhe ai fton Z. Klaus Ressmann per te vepruar si Sekretar i Asamblese se Pergjithshme. Pas verifikimit te te tere Ortakeve, Kryetari konfirmon se te tera kerkesat per te mbledhur nje Asamble te Pergjithshme te rregullt, jane permbushur sipas Statutit te Shoqerise dhe Legjislacionit Shqiptar, dhe ai

M
[Signatures]

deklaron se Asambleja e Pergjithshme eshte thirrur ne menyre te rregullt per te diskutuar dhe vendosur sa me poshte:

RENDI I DITES:

Vendimi ne lidhje me modifikimin e Statutit te Golden Eagle SHPK;


Golden Eagle SHPK eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, bazuar ne Ligjin nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", e regjistruar rregullisht ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me Vendimin No 3709 i dates 27.04.1992 dhe ri-regjistruar me Vendimin No 3709/1 i dates 05.06.1993, me nje Kapital prej 8 800 000 USD, te ndare ne 8 800 pjese, me nje vlere nominale prej 1 000 USD secila, me seli ne: "Hotel Rogner EuropaPark" Bvd. Deshmoret e Kombit, Tirana, Shqiperi. Bordi i Administratoreve te Golden Eagle SHPK perbehet nga: Z. Robert Rogner jun, Z. Klaus Ressmann, Z. Gerhard Stranner.

Pas diskutimeve dhe shqyrtimeve te ndryshimeve dhe amendimeve te Statutit te Golden Eagle SHPK, ortaket, te cilet perfaqesojne 100% te pjeseve te kapitalit te Golden Eagle SHPK unanimitisht:


- VENDOSEN te miratojne ndryshimet dhe amendimet e statutit te Golden Eagle SHPK. Statuti me ndryshimet dhe amendimet, mbi te cilat eshte rene dakord dhe i firmosur rregullisht nga Ortaket, i bashkelidhet ketij Vendimi dhe konsiderohet pjese e pandare e tij.
- VENDOSEN te miratojne ndryshimin e emrit nga "Shqiponja e Arte SHPK" ne "Golden Eagle SHPK".
- VENDOSEN me tej qe Z. Klaus Ressmann, ne cilesine e Administratorit te Golden Eagle SHPK, autorizohet te ekzekutoje dhe dorezoje ne emer dhe per llogari te Shoqerise cdo dokument te nevojshem per te zbatuar kete Vendim, duke perfshire por duke mos u kufizuar ne depozitimin e ketij Vendimi dhe regjistrimin e Statutit te ndryshuar dhe amenduar ne "Regjistrin Tregtar" te Gjykates se rrethit Gjyqesor Tirane si dhe prane cdo Autoriteti tjeter Shqiptar, ashtu sic kerkohet nga legjislacioni Shqiptar.

Asnje vendim tjeter nuk u morr ne Asamblene e Pergjithshme te Golden Eagle SHPK, e cila u mbyll ne oren 16:00.

Ky Vendim u nenshkrua ne kater (4) kopje ne Anglisht dhe kater (4) kopje ne Shqip. Ne rast te ndonje kontradite ndermjet versioneve Anglisht dhe Shqip, versioni Anglisht do te jete i detyrueshem per t'u zbatuar dhe i vetmi qe do te sjelle pasoja ligjore.



Une, Noterja, pasi ua lexova kete Vendim Paleve pjesemarrrese me ze te larte, u binda se palet e pranojne kete Vendim sipas vullnetit te tyre te lire dhe Une vertetoj nenshkrimin e tyre sipas Ligjit.



ORTAKET:

FEWO Beteiligungs Verwaltung GmbH
Nga: Z. Robert Rogner
Perfaqesues i Autorizuar

BERZH (Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim)

Nga: Z. Murat Yildiran
Perfaqesues i Autorizuar

MURAT YILDIRAN
Murat YILDIRAN

Rogner International Hotels & Resorts GmbH

Nga: Znj. Flonja Borici
Perfaqesues i Autorizuar

KRYETARI
Robert Rogner
Z. Robert Rogner

SEKRETARI
KLAUS RESSMANN
Z. Klaus Ressmann



NOTERE
Arjana Mallkuqi

PERKTHYES

EVISA SHEHAJ
PERKTHYES
TRANSLATOR
Tel. 0692291751

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA E TIRANES

Nr. 10430/2 prot

Tirane 6 dhjetor 1993
Shqiponjes se Arte SH.P.K.

Per njoftim BERZH
Keshillit te Pergjithshem

Londer

Te dashur Zotërinj,

Ketu me poshte ne vertetojme dhe garantojme se, sipas planit urbanistik te Bashkise se Tiranës te ndryshuar me..... dhjetor 1993, parcelat nr. 239/66, 241/64, 243/62, 245/60 dhe 247/58 konsiderohen si zona plotesisht te mbrojtura dhe nuk do te jepet asnje leje ndertimore apo ndertese te çdo tipi ose natyre lidhur me keto parcela.

Tuajet me vertetesi

Kryetari i Drejtorise Urbanistike

Koço Kaskaviqi

Kryetari i Zyres se Kadastres

Sinan Koçaj

Kryetari i Bashkise se Tiranës

Sali Kelmendi



KERKESE

KERKUES :

Shqipëria e Arta

OBJEKTI :

Terheqe kopje te legalizuar te praktikes se depozituar prane
Regjistrat Tregtar te shoqerise tregtar

BAZA LIGJORE :

Neni 14/2 I ligjit Nr.7632 dt.04.11.1992; Neni 28 I ligjit
Nr.7667 dt.28.12.1993.

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
Zyres se Regjistrat Tregtar
TIRANE

Une kerkuesi jam :

Aksioner

Administrator

Perfaqesues

I shoqerise tregtare

vendimin Nr. 3709 date 1992 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Per arsye se :

Praktika

Vendimi

Ekstrat tjeter

I shoqerise nuk disponohet nga ana jone pasi ku kurr

ju lutemi te na vihete ne dispozicion nje kopje e legalizuar e saj.

Bashkangjitur po ju le :

Fotokopje te pasaportes

Fotokopje te procures

Autorizim

JU FALEMINDERIT PER MIREKUPTIMIN

Valent P...
NENSHKRUAN

nes se kryeshtu
Per kopjet e...
ku kurr
P...


REGISTRATION OF OWNERSHIP OF SHARES

REGISTRATION No 6

I, Robert Rogner jun, acting as Chairman and legal representative of Golden Eagle ShKP, registered with the District Court of Tirana on June 5, 1993, herewith certify:

1. That the total social capital of the Company on the date below amounts to eight million eight hundred thousand US Dollars (US \$ 8,800,000) divided into no. 6,300 Ordinary Shares of par value of one thousand US Dollars (US \$ 1,000) each and no. 2,500 Series B Preference Shares of par value of one thousand US Dollars (US \$ 1,000) each.
2. That Rogner Ges.m.b.H., an Austrian limited liability company with registered headquarters at Widmannngasse 43, 9500 Villach, Austria, has acquired ownership of six thousand three hundred (6,300) Ordinary Shares of par value one thousand US Dollars (US\$ 1,000.00) each. That Rogner GmbH has acquired the said 6,300 shares by paying the amount of ten thousand US Dollars (US\$ 10,000.00) into the capital account of Golden Eagle ShPK with the Savings Bank (Banka e Kursimeve) in Tirana, Albania, and by paying the amount of six million two hundred ninety thousand US-Dollars (US\$ 6,290,000.00) into the capital account of Golden Eagle ShPK with the Bank Austria AG in Villach, Austria.
3. That the European Bank for Reconstruction and Development (EBRD), with registered headquarters at One Exchange Square, London EC2A2JN, United Kingdom, has acquired ownership of two thousand five hundred (2,500) Series B Preference Shares of par value one thousand US Dollars (US\$ 1,000.00) each. That EBRD has acquired the said 2,500 preference shares by paying the amount of two million five hundred thousand US-Dollars (US\$ 2,500,000.00) into the capital account of Golden Eagle ShPK with the Bank Austria AG in Villach, Austria.

April 4, 2000


Golden Eagle ShPK
Robert Rogner jun., Chairman

RREGJISTRIMI I PRONESISE MBI AKSIONET


RREGJISTRIMI Nr. 6

Une, Robert Rogner i riu, duke vepruar si Kryetar dhe perfaqesues ligjor i Golden Eagle Sh.p.k., rregjistruar ne Gjykatën e Tiranës me 5 Qershor 1993, vertetohet qe:

1. Totali i kapitalit social te Shoqerise ne datën e meposhtme konsiston ne tete milion e teteqind mije Dollare US (8,800,000 \$US) te ndare ne 6,300 Aksione te Zakonshme me vlere nje mije Dollare US (1,000 \$US) secili dhe 2,500 Aksione Preferenciale te Serise B me vlere nje mije Dollare US (1,000 \$US) secili.
2. Rogner Ges.m.b.H, nje shoqeri Austriake me pergjegjesi te kufizuar me seli qendrore te rregjistruar ne Widmannngasse 43, 9500 Villach, Austri, ka fituar pronesine e gjashtemije e treqind (6,300) Aksioneve te Zakonshme me vlere nje mije Dollare US (1,000 \$US) secili. Rogner GmbH ka fituar 6,300 aksionet e siperpermendura duke paguar shumën prej dhjetemije Dollare US (10,000.00 \$US) ne llogarine e kapitalit te Golden Eagle Sh.p.k ne Banken e Kursimeve ne Tirane, Shqiperi si dhe duke paguar shumën prej gjashte milion dyqind e nentdhjetemije Dollare US (6,290,000.00 \$US) ne llogarine e kapitalit te Golden Eagle Sh.p.k. ne Banken e Austrise AG ne Villach, Austri.
- (1) Marreveshjet dhe instrumentet me ane te cilave Banka merr persiper te jape hua, investime nepermjet kapitaleve private, angazhime garancie dhe sigurimi apo per te marre persiper operacione te ngjashme, duke perfshire marreveshje huaje, marreveshje abonimi, marreveshje per blerje aksionesh dhe te pritshme.
- (2) Marreveshjet dhe instrumentet qe do te ekzekutohen perpara dhe ne zbatim te marreveshjeve te permendura ne piken (1), duke perfshire leter mandatet, ndermarrjet konfidenciale, marreveshjet e agjencise, zbatimin e tyre ose marreveshjet e bashke-financimit, marreveshje per projekte, marreveshje apo instrumente qe japin garanci apo siguri ne favor te Bankes, marreveshjet e ndarjes se sigurimit, marreveshjet ndermjet kreditoreve, marreveshjet qe kane te bejne me tjetersimin e aseteteve mbi te cilat Banka ka nje interes sigurimi, marreveshjet per fondet e financimit te projekteve, marreveshje per perfundimin apo mbeshtetjen e projekteve, marreveshje menaxhimi, marreveshje pjesemarrje, kalim huaje apo marreveshjet e zevendesimit te kontrates ekzistuese, marreveshjet per trajtimin e aksioneve ne treg, dhe marreveshjet e terheqjes se kapitaleve.
- (3) Shtesat, ndryshimet, njoftimet, kerkesat dhe te rejat mbi marreveshjet dhe instrumentet sipas pikave (1) ose (2), perfshire njoftimet per rishikimin e grafikut te amortizimit, njoftimet e pezullimit apo shuarjes, njoftimet e heqjes dore apo pelqimit, njoftimet e mospermbushjes dhe njoftimet e persheptimit.

(4) Prokurat per ekzekutimin e dokumenteve sipas pikave (1) ose (2) ose (3); prokurat per mbledhjet e aksionereve dhe kreditoreve; marreveshjet e shperblimit ndermejt Bankes dhe te caktuarve prej saj te cilat veprojne si drejtore te kompanive ne te cilat eshte kryer investimi.

(c) Caktojne Mary Ellen Collins si Drejtore Grupit te Punes, Departamenti i Rimekembjes Financiare ne Banke.

(d) Bashkelidhur eshte nje kopje origjinale e Aktit te Autorizimit per Nenshkrim qe mban daten 25 mars 2004, nenshkruar nga Mary Ellen Collins ne vijim te Urdherit Administrativ, sipas te cilit Giulio Moreno, Drejtor i Zyres se Tiranes dhe Donald Mishaxhi, Analist Karriere ne Zyren Rezidente te Tiranes, jane autorizuar individualisht te nenshkruaje per dhe ne emer te Bankes cdo dhe te gjitha instrumentet ne forme te shkruar te cilat referohet ketu.

Nenshkruar nga une dhe vulosur me Vulen e Bankes me 30 maj 2004 ne Londer.

Colm Lincoln
Asistent Sekretari i Pergjithshem

AKTI I AUTORIZIMIT PER NENSHKRIM

Per te permbushur kompetencen qe me eshte dhene nga Urdheri Administrativ i dates 3 tetor 1994 me titull: "Nenshkrimi i Instrumentave ne Forme te Shkruar: Per Caktimin e Zyrtareve", ndryshuar nga kjo date, nenshkruar nga Presidenti i Bankes Europiane per Rindertim dhe Zhvillim ("Banka") ne baze te Nenit 30, paragrafi 4 i Marreveshjes qe krijon Banken, une autorizoj individualisht Giulio Moreno, Drejtori i Zyres se Tiranes dhe Donald Mishaxhi, Analist Karriere ne Zyren e Perhershme ne Tirane qe te nenshkruajne per dhe ne emer te Bankes, cdo dhe te gjitha instrumentet ne forme te shkruar per transferimin e aksioneve sipas ushtrimit pjesor te nje opcioni te vendosur qe ushtrohet ne perputhje me dokumentat e financimit te ekzekutuara ndermjet, inter alia, Bankes dhe Golden Eagle ShpK, kompani e cila eshte themeluar dhe ekziston sipas ligjeve te Shqiperise.

Autoriteti per te nenshkruar do te jete ne fuqi deri me 30 shtator 2004, perfshire dhe kete date. Ky autoritet jepet ne vazhdim, pa kufizuar autoritetin te dhene me pare, te cdo autoriteti qe eshte dhene ne te kaluaren. Mbarimi apo perfundimi i mundshem i afatit te ketij autoriteti nuk do te preke asnje veprim te kryer me pare apo qe do te kryhet per ushtrimin e kesaj kompetence.


Nenshkruar ne Londer me 30 Mars 2004

Mary Ellen Collins

Drejtoresh e Grupit te Punes, Departamenti i Rimekembjes Financiare ne Banke

Per kthim

Flora Bori si




Republika e Shqiperise
Dhoma e notereve
Tirane
Nr 1013 Rep

Tirane, me 25 maj 2004

VERTETIM

Vertetohet firma e perkthyeses Flonja Boriçi, banuese ne Tirane, e njohur personalisht prej meje noteres, e cila me deklaroi se perktheu saktesisht, nga gjuha angleze ne gjuhen shqipe, dokumentin bashkelidhur dhe nenshkroi rregullisht ne pranine time.

Notere
Irena Laha



3709/1

5 M Decti -
01 QERSHOR 2004



REPUBLIKA E SHQIPERISE

KERKESE

KERKUES: Shoqeria "Shqiponja e Arte"

Objekti: Kerkohet pasqyrimi ne Rregjistrin Tregtar i transferimi te 982 pjesete te kapitalit te shoqerise me nje vlere nominale prej 1000 (njemije) US dollare secila, prej BERZH tek Rogner International Hotels & Resorts GmbH dhe emorimi i Bordit te ri te Drejtoreve te shoqerise "Shqiponja e Arte" SH.P.K.

Per kompetence:

(7)

GJYKATES SE RRETHIT
TIRANE

Shoqeria "Shqiponja e Arte" SH.P.K. (Golden Eagle) eshte person juridik, i reregjistruar ne baze te vendimit Nr.3709, date 27.04.1992 dhe ri-reregjistruar ne date 05.06.1993 me vendimin Nr.3709/1, me:

- Ortake (1) Rogner GmbH; (2) Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim;
- Kapital themeltar; 8.800.000 USD
- Perfaqesues i Shoqerise: Z.Klaus Ressimann, Drejtor administrativ;
- Selia: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Nr.8, Tirane, Shqiperi.

Meqenese:

Me ane te nje Vendimi Qarkullues, ortaket e shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. », me prill 2004, moren vendimet e meposhtme:

1. U VENDOS QE te aprovohet transferimi i 982 pjeseve te kapitalit te shoqerise me nje vlere nominale prej 1000 (njemije) US dollare secila, prej BERZH tek Rogner International Hotels & Resorts GmbH.
2. U VENDOS QE ky aprovim eshte dhene duke iu referuar ne menyre te veçante, si dhe ashtu siç kerkohet, nga neni 47 i Ligjit shqiptar nr. 7638, date 19.11.1992, « Per shoqerite tregtare ».
3. U VENDOS QE te hiqet dore ne menyre te parevokueshme nga çdo e drejte e parablerjes siç eshte parashikuar ne nenin 11 te statutit te shoqerise.



4. U VENDOS QE Bordi aktual i Drejtoreve te shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » te shperndahet ne menyre efektive qe nga data e ketij vendimi ;
5. U VENDOS QE, qe nga data e shperndarjes se Bordit aktual, te emerohet nje Bord i ri Drejtoresh te shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » i perbere si meposhte :
 - a. Riemerohet zoti Robert Rogner jun. si Drejtor per nje tjeter periudhe siç parashikohet ne statutin e shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » ;
 - b. Riemerohet zoti Klaus Ressimann, si Drejtor administrativ per nje tjeter periudhe siç parashikohet ne statutin e shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » ;
 - c. Emerohet zoti Gerhard Stranner, nenshtetas austriak, si Drejtor i trete siç kerkohet nga statuti i shoqerise.
6. U VENDOS QE zoti Klaus Ressimann, Drejtor administrativ i shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. », eshte i autorizuar te ekzekutoje dhe te jape ne emer te shoqerise te gjitha dokumentat e nevojshme per te zbatuar vendimet e mesiperme dhe ne pergjithesi per te bere çdo gje te nevojshme per te plotesuar dhe bere efektive transferimin e pjeseve te kapitalit dhe emerimet ne Bord te pershkurara si me siper, duke perfshire por pa u limituar ne emerimin e Bordit te ri, partnerit te ardhshem Rogner International Hotels & Resorts GmbH dhe shperndarjen e re te pjeseve te kapitalit ne shoqeri, regjistrimin ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se rrethit te Tiranës dhe me çdo lloj autoriteti tjeter shqiptar, siç kerkohet nga ligji shqiptar.

Kerkohet:

Te pasqyrohet sa me siper ne Rregjistrin Tregtar.

“Shqiponja e Arte”Sh.p.k.

Perfaqesuesi
Klaus Ressimann
Drejtor administrativ

Republika e Shqiperise
Dhoma e Notereve Tirane
Nr. 222/Rep

Vertetim

Sot me date 25.05.2004 u paraqit perpara meje Noteres se Dhomes se Notereve Tirane, Irena Laha, Z.Klaus Joseph Ressmann ,shtetas Austriak dtl.1941 me adrese:Durergasse 15,A-1060,Viene, Austri, ne cilesine e Drejtorit administrativ te Shoqerise "Shqiponja e arte Sh.p.k.", madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i cili me deklaroi se sa me siper eshte nje kerkese e shoqerise "Shqiponja e arte Sh.p.k.", redaktuar jashte kesaj zyre, te cilen e firmosi ne prani te perkthyeses Flonja Boriçi, rregullisht dhe me vullnet te lire dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE
Irena Laha



Republika e Shqiperise
Dhoma e Notereve
Tirane
Nr. 998 Rep.
N. 96, Kol,



Tirane, me 25 maj 2004

Kontrate transferimi i pjeseve te kapitalit
(shitje kuotash)

Sot, me daten 25 maj 2004, para meje noteres Irena Laha, u paraqiten personalisht palet te cilat me kerkuan redaktimin e kontrates si me poshte :

Shitesi : Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim, BERZH, nje organizate internacionale me seli ne One Exchange Square, London EC2A 2JN, England / United Kingdom, perfaqesuar nga zoti Giulio Moreno, lindur me 19. 02. 1959, ne Rome, banues ne rr. Abdi Toptani, Drin Tower, kati 4, nenshtetas italian, me numer pashaporte B 252402, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar prej meje, me prokure te posaqme nr. G384756, te dates 01.04.2004, leshuar nga Mary Ellen Collins, noterizuar nga noteri publik Jeremy Brooker Burgess, ne Londer.

Bleresi : Rogner International Hotels & Resorts GmbH, nje shoqeri e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjit austriak me seli ne 118 Breitenfurterstrasse, A-1230 Viene, Austri, perfaqesuar nga zoti Klaus Ressimann, lindur me 10 qershor 1941, banues ne Duerergasse 15, A-1060, Viene, Austri, nenshtetas austriak, me numer pashaporte J 0555123 3, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar prej meje, i pajisur me prokure te posaqme nr. 1832/ 2004, te dates 13.05.2004, leshuar nga Klaus Hofmann, noterizuar nga noteri publik Dr Peter Zdesar, ne Villach.

Te pergjithshme

A. Shitesi zoteron 2500 pjese kapitali ne kapitalin e shoqerise « Shqiponja e arte sh.p.k . », nje shoqeri qe ekziston sipas ligjeve shqiptare, regjistruar ne Gjykatën e rrethit te Tiranes, me 5 qershor 1993 me vendim numer 3709 / 1, me seli ne Bvd. Deshmoret e Kombit (Hotel Europark), Tirana, Albania, (« Shoqeria ») ;

B. Bleresi nuk ka zoteruar pjese te kapitalit te Shoqerise.

C. Te gjithe ortaket e Shoqerise kane miratuar, ne perputhje me nenet statutore te shoqerise, transferimin e 982 pjeseve te kapitalit nga Shitesi tek Bleresi, me ane te nje vendimi te asamblese te dates 7 prill 2004, dokument qe i bashkengjitet kesaj kontrate.


Palet bien dakort si me poshte :

1. Shitesi konfirmon qe eshte paguar plotesisht nga Bleresi, sipas çmimit te rene dakort me te. Si rrjedhim, ai transferon, ne pronesine e Bleresit, 982 pjese kapitali me nje vlere nominale prej 1000 (njemije) US Dollare secila, te zoteruara ne kapitalin e shoqerise « Shqiponja e arte sh.p.k. ». Shitesi garanton Bleresin qe 982 pjeset e transferuara te kapitalit te jane krejtesisht te lira nga çdo peng dhe barre.

2. Bleresi pranon pronesine e 982 pjeseve te kapitalit te mesiperm, te lira nga çdo peng dhe barre dhe pranon te gjitha te drejtat dhe detyrimet e ortakut te Shoqerise sipas statutit te Shoqerise.


3. Shitesi dhe Bleresi pranojne te zbatojne e t'i japin njeri tjetrit dhe/ose Shoqerise me kerkese te pales tjetere dhe/ose Shoqerise, te gjitha dokumentacionin e duhur ne pergjithesi, per te kryer çdo gje te nevojshme per transferimin e pjeseve te kapitalit, qe jane objekt i kesaj kontrate, dhe per ta regjistruar kete transferim ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se rrethit te Tiranës, si edhe ne cdo organ tjetere shqiptar sipas ligjeve shqiptare.

Kjo kontrate u perpilua ne 4 kopje me vlere te barabarte ligjore. Ajo ju lexua dhe ju perkthye paleve saktesisht, nga gjuha shqipe ne gjuhen angleze, nga perkthyesja Flonja Boriçi. Kontrata u pranua nga palet dhe u gjend sipas vullnetit te tyre te lire dhe te shprehur. Ajo u nenshkrua ne menyre te rregullt, nga palet, para meje, dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.



Rogner International Hotels
& Resorts GmbH, Bleresi



Emri : Klaus Rössmann



Banka Europiane per
Rindertim dhe Zhvillim,
BERZH, Shitesi

Emri : Giulio Moreno


NOTER
IRENA LANA
TIRANE



TAKOVA U PAGUA

Pu Perkthyesse

Flonja Boriçi



no



PROKURE E POSACME

ATIJ QE I PERKET

Une, Klaus Hofmann, nenshtetas austriak, lindur me 30 prill 1968, ne cilesine time si Drejtor administrativ i shoqerise austriake Rogner International Hotels and Resorts GmbH, Breitenfurterstrasse 118, A-1230 Viene, Austri, dhe ne kete cilesi i autorizuar te veprojt ne emer te Rogner International Hotels and Resorts GmbH, pa kushtezime, autorizoj si me poshte

Zotin Klaus Ressmann, qytetar austriak, lindur me 10 qershor 1941,

te hartoje, nenshkruaj dhe te jape ne emer te Rogner International Hotels and Resorts GmbH, çdo dokument dhe ne pergjithesi te beje gjithçka te nevojshme per te plotesuar dhe bere efektive transferimin e 982 pjeseve te kapitalit me vlere nominale njemije US - dollare, nga Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim (BERZH) te Rogner International Hotels and Resorts GmbH, pjese keto te zoteruara nga Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim (BERZH), Londer, ne kapitalin e shoqerise « Shqiptonja e arte sh.p.k. », shoqeri shqiptare, e regjistruar ne Regjistrin tregtar me numer 3709 / 1 nga Gjykata e rrethit te Tiranës. Ne lidhje me transferimin e pjeseve te kapitalit te mesiperm, kjo prokure e posaçme, jepet, ne veçanti - por jo vetem per kete - per perpilimin e aktit noterial te transferimit dhe per regjistrimin e Rogner International Hotels and Resorts GmbH si ortak i shoqerise « Shqiptonja e arte sh.p.k. » ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit te Tiranës dhe per çdo autoritet tjeter shqiptar te kerkuar nga ligji shqiptar.

Leshuar me 13 maj 2004

_____(Firma)

Rogner International Hotels and Resorts GmbH
Klaus Hofmann, Drejtor administrativ

Pikthea

Flora Borisi

Ne Rep : 1832 /2004

Firma e dhene per Rogner International Hotels and Resorts GmbH, me seli ne Viene, nga zoti Klaus Hofmann, lindur me 30.04.1968 (tridhjetë prill njëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tete), afarist ne turizem, rezident ne 23 /II/4, 1180 Viene, ne cilesine e Drejtorit administrativ, eshte autentike.

Zoti Klaus Hofmann ne cilesine e Drejtorit administrativ eshte i autorizuar te perfaqesoje i vetem Rogner International Hotels and Resorts GmbH, gje qe e vertetova sot ne Regjistrin Tregtar, te Gjykates Tregtare te Vienes, ne numrin e Regjistrit Tregtar 103924 f.

Villach, me 13.05.2004 (trembedhjetë maj dymijë e kater).


Taxa noteriale prej 13 Euro eshte paguar.

(Vula : Dr. Peter ZDESAR, noter publik, Villach, Käntern)

(Nenshkrimi)

Per kthau

Flonja Borisi



Republika e Shqiperise
Dhoma e notereve
Tirane
Nr 988 Rep

Tirane, me 25 maj 2004

VERTETIM

Vertetohet firma e perkthyeses Flonja Boriçi, banuese ne Tirane, e njohur personalisht prej meje noteres, e cila me deklaroi se perktheu saktesisht, nga gjuha gjermane ne gjuhen shqipe, dokumentin bashkelidhur dhe nenshkroi rregullisht ne pranine time.

Notere
Irena Laha



Vendim qarkullues i Asamblese se ortakeve te shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. »



Njoftim Ortakeve te shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » :

1. Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim, BERZH

One Exchange Square
London EC2A 2JN
England / United Kingdom
Fax : +44 207 338 7595

2 . Rogner GmbH

Nikolaigasse 22
A- 9500 Villach
Austria
Fax : +43 4343 25 571

Nga : Zoti Robert Rogner jun.
President i shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. »
C/o Rogner GmbH
Breitenfurterstrasse 118
A-1230 Vienna, Austria

Data : 2 prill 2004

Te dashur ortake,

Duke u mbeshtetur ne nenin 13.7 te statutit te shoqerise, ortaket e shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » mund te marrin çdo vendim ne menyre qarkulluese, pa mbledhje.

Ortaku Rogner GmbH njofton shoqerine « Shqiponja e Arte sh.p.k. » qe nuk ka asnje kundershtrim qe 982 pjeset e kapitalit qe zoteron BERZH ne kapitalin e shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » te transferohen nga BERZH tek Rogner International Hotels & Resorts GmbH, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar austriake me seli ne Breitenfurterstrasse 118, 1230 Viene, Austri. Shoqeria « Shqiponja e Arte sh.p.k. » eshte informuar gjithashtu ne menyre te rregullt mbi kete transferim.

Si rrjedhim, une zoti Robert Rogner jun., President i shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. », ju propozoj ortakeve vendimet e meposhtme :

1. TE VENDOSSET QE te aprovohet transferimi i 982 pjeseve te kapitalit te shoqerise me nje vlere nominale prej 1000 (njemije) US dollare secila, prej BERZH tek Rogner International Hotels & Resorts GmbH.

239

2. TE VENDOSSET QE ky aprovim eshte dhene duke iu referuar ne menyre te veçante, si dhe ashtu siç kerkohet, nga neni 47 i Ligjit shqiptar nr. 7638, date 19.11.1992, « Per shoqerite tregtare ».
3. TE VENDOSSET QE te hiqet dore ne menyre te parevokueshme nga çdo e drejte e parablerjes siç eshte parashikuar ne nenin 11 te statutit te shoqerise.

Duke marre ne konsiderate kerkesen e BERZH per te mos qene me tej e prezantuar ne Bordin e Drejtoreve te shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. », une zoti Robert Rogner jun., President i shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. », ju propozoj ortakeve vendimet e meposhtme :

4. TE VENDOSSET QE Bordi aktual i Drejtoreve te shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » te shperndahet ne menyre efektive qe nga data e ketij vendimi ;
5. TE VENDOSSET QE, qe nga data e shperndarjes se Bordit aktual, te emerohet nje Bord i ri Drejtoresh te shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » i perbere si meposhte :
 - a. Riemerohet zoti Robert Rogner jun. si Drejtor per nje tjeter periudhe siç parashikohet ne statutin e shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » ;
 - b. Riemerohet zoti Klaus Rössmann, si Drejtor administrativ per nje tjeter periudhe siç parashikohet ne statutin e shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » ;
 - c. Emerohet zoti Gerhard Stranner, nenshtetas austriak, si Drejtor i trete siç kerkohet nga statuti i shoqerise.
6. TE VENDOSSET QE zoti Klaus Rössmann, Drejtor administrativ i shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. », eshte i autorizuar te ekzekutoje dhe te jape ne emer te shoqerise te gjitha dokumentat e nevojshme per te zbatuar vendimet e mesiperme dhe ne pergjithesi per te bere çdo gje te nevojshme per te plotesuar dhe bere efektive transferimin e pjeseve te kapitalit dhe emerimet ne Bord te pershkurara si me siper, duke perfshire por pa u limituar ne emerimin e Bordit te ri, partnerit te ardhshem Rogner International Hotels & Resorts GmbH dhe shperndarjen e re te pjeseve te kapitalit ne shoqeri, regjistrimin ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se rrethit te Tiranes dhe me çdo lloj autoriteti tjeter shqiptar, siç kerkohet nga ligji shqiptar.

Ju lutem vendosni voten tuaj duke nenshkruar me poshte dhe kthejini nje kopje te ketij dokumenti me fax zotit Klaus Rössmann, shoqeria « Shqiponja e Arte sh.p.k. » c/o Rogner GmbH, Breitenfurterstrasse 118, A-1230, Viene, Austri (fax : +43-1-80 45 247) dhe dergoni du origjinale te nenshkruar me poste te regjistruar.

Faleminderit per bashkepunimin.

_____(nenshkrimi)
« Shqiponja e Arte sh.p.k. »
Robert Rogner jun. President

Ortaket e shoqërisë « Shqiponja e Arte sh.p.k. » hodhen votën e mëposhtme për sa i përket 6 vendimeve mbi transferimin e 982 pjesëve të kapitalit dhe emerimin e Bordit të Drejtoreve të shoqërisë « Shqiponja e Arte sh.p.k. », vendime të propozuara në mënyrë qarkulluese më 2 prill 2004.

Votimi :

Vendimet aprovohen :

Ortaku BERZH
Emri, pozicioni

Vendi, data : _____

Vendimet hidhen poshtë :

Ortaku BERZH
Emri, pozicioni

Vendi, data : _____

Vendimet aprovohen :

_____(Firma)
Ortaku Rogner GmbH
Robert Rogner sen., Drejtor administrativ

Vendi, data : Villach, 5.4.2004

Vendimet hidhen poshtë :

Ortaku Rogner GmbH
Robert Rogner sen., Drejtor administrativ

Vendi, data : _____

Pishtar

Flanja Boci



Shqiponja e Arte sh.p.k.

Republika e Shqiperise

Dhoma e notereve

Tirane

Nr 850 Rep

Tirane, me 25 maj 2004

VERTETIM

Vertetohet firma e perkthyeses Flonja Boriçi, banuese ne Tirane, e njohur personalisht prej meje noteres, e cila me deklaroi se perktheu saktesisht, nga gjuha angleze ne gjuhen shqipe, dokumentat bashkelidhur dhe nenshkroi rregullisht ne pranine time.

Notere
Irena Laha



Vendim qarkullues i Asamblese se ortakeve te shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. »

Komunikim i vendimit qarkullues

Ortakeve te shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » :

1. Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim, BERZH

One Exchange Square
London EC2A 2JN
England / United Kingdom
Fax : +44 207 338 7595

2 . Rogner GmbH

Nikolaigasse 22
A- 9500 Villach
Austria
Fax : +43 4343 25 571

Nga : Zoti Robert Rogner jun.
President i shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. »
C/o Rogner GmbH
Breitenfurterstrasse 118
A-1230 Vienna, Austria

Data : 21 prill 2004

Te dashur ortake,

Me ane te nje Njoftimi, ju kam transmetuar, me 2 prill 2004, nje propozim per nje vendim qarkullues si meposhte :

1. TE VENDOSET QE te aprovohet transferimi i 982 pjeseve te kapitalit te shoqerise me nje vlere nominale prej 1000 (njemije) US dollare secila, prej BERZH tek Rogner International Hotels & Resorts GmbH.
2. TE VENDOSET QE ky aprovim eshte dhene duke iu referuar ne menyre te veçante, si dhe ashtu siç kerkohet, nga neni 47 i Ligjit shqiptar nr. 7638, date 19.11.1992, « Per shoqerite tregtare ».
3. TE VENDOSET QE te hiqet dore ne menyre te parevokueshme nga çdo e drejte e parablerjes siç eshte parashikuar ne nenin 11 te statutit te shoqerise.
4. TE VENDOSET QE Bordi aktual i Drejtoreve te shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » te shperndahet ne menyre efektive qe nga data e ketij vendimi ;

Rezultati i vendimit qarkullues

5. TE VENDOSSET QE, qe nga data e shperndarjes se Bordit aktual, te emerohet nje Bord i ri Drejtoresh te shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » i perbere si meposhte :
- a. Riemerohet zoti Robert Rogner jun. si Drejtor per nje tjeter periudhe siç parashikohet ne statutin e shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » ;
Riemerohet zoti Klaus Ressmann, si Drejtor administrativ per nje tjeter periudhe siç parashikohet ne statutin e shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » ;
Emerohet zoti Gerhard Stranner, nenshtetas austriak, si Drejtor i trete siç kerkohet nga statuti i shoqerise.
6. TE VENDOSSET QE zoti Klaus Ressmann, Drejtor administrativ i shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. », eshte i autorizuar te ekzekutoje dhe te jape ne emer te shoqerise te gjitha dokumentat e nevojshme per te zbatuar vendimet e mesiperme dhe ne pergjithesi per te bere çdo gje te nevojshme per te plotesuar dhe bere efektive transferimin e pjeseve te kapitalit dhe emerimet ne Bord te pershkurara si me siper, duke perfshire por pa u limituar ne emerimin e Bordit te ri, partnerit te ardhshem Rogner International Hotels & Resorts GmbH dhe shperndarjen e re te pjeseve te kapitalit ne shoqeri, regjistrimin ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se rrethit te Tiranes dhe me çdo lloj autoriteti tjeter shqiptar, siç kerkohet nga ligji shqiptar.

Une ju informoj qe kam marre me poste te regjistruar votat perfundimtare si me poshte :

Ortaku BERZH, te gjashta vendimet jane aprovuar me 7 prill 2004 ;

Ortaku Rogner GmbH, te gjashta vendimet jane aprovuar me 5 prill 2004 ;


Si rrjedhim, te gjashte vendimet e mesiperme jane aprovuar me unanimitet nga te gjithë ortaket e shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » ne menyre efektive me 7 prill 2004.

_____ (nenshkrimi)

« Shqiponja e Arte sh.p.k. »
Robert Rogner jun. President

Per kthim

Flora Borici



Shqiponja e Arte sh.p.k.

Republika e Shqiperise
Dhoma e notereve
Tirane
Nr 989 Rep

Tirane, me 25 maj 2004

VERTETIM

Vertetohet firma e perkthyeses Flonja Boriçi, banuese ne Tirane, e njohur personalisht prej meje noteres, e cila me deklaroi se perktheu saktesisht, nga gjuha angleze ne gjuhen shqipe, dokumentat bashkelidhur dhe nenshkroi rregullisht ne pranine time.

Notere
Irena Laha



Rezultati i vendimit qarkullues

235

Vendim qarkullues i Asamblese se ortakeve te shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. »

Njoftim Ortakeve te shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » :

1. Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim, BERZH

One Exchange Square
London EC2A 2JN
England / United Kingdom
Fax : +44 207 338 7595

2 . Rogner GmbH

Nikolaigasse 22
A- 9500 Villach
Austria
Fax : +43 4343 25 571

Nga : Zoti Robert Rogner jun.
President i shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. »
C/o Rogner GmbH
Breitenfurterstrasse 118
A-1230 Vienna, Austria

Data : 2 prill 2004

Te dashur ortake,

Duke u mbeshtetur ne nenin 13.7 te statutit te shoqerise, ortaket e shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » mund te marrin çdo vendim ne menyre qarkulluese, pa mbledhje.

Ortaku Rogner GmbH njofton shoqerine « Shqiponja e Arte sh.p.k. » qe nuk ka asnje kundershtrim 982 pjeset e kapitalit qe zoteron BERZH ne kapitalin e shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » te transferohen nga BERZH tek Rogner International Hotels & Resorts GmbH, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar austriake me seli ne Breitenfurterstrasse 118, 1230 Viene, Austri. Shoqeria « Shqiponja e Arte sh.p.k. » eshte informuar gjithashtu ne menyre te rregullt mbi kete transferim.

Si rrjedhim, une zoti Robert Rogner jun., President i shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. », ju propozoj ortakeve vendimet e mepostme :

1. TE VENDOSSET QE te aprovohet transferimi i 982 pjeseve te kapitalit te shoqerise me nje vlere nominale prej 1000 (njemije) US dollare secila, prej BERZH tek Rogner International Hotels & Resorts GmbH.

2. TE VENDOSSET QE ky aprovim eshte dhene duke iu referuar ne menyre te veçante, si dhe ashtu siç kerkohet, nga neni 47 i Ligjit shqiptar nr. 7638, date 19.11.1992, « Per shoqerite tregtare ».

3. TE VENDOSSET QE te hiqet dore ne menyre te parevokueshme nga çdo e drejte e parashlyerjes siç eshte parashikuar ne nenin 11 te statutit te shoqerise.

Duke marre ne konsiderate kerkesen e BERZH per te mos qene me tej e prezantuar ne Bordin e Drejtoreve te shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. », une zoti Robert Rogner jun., President i shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. », ju propozoj ortakeve vendimet e meposhtme :

4. TE VENDOSSET QE Bordi aktual i Drejtoreve te shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » te shperndahet ne menyre efektive qe nga data e ketij vendimi ;

5. TE VENDOSSET QE, qe nga data e shperndarjes se Bordit aktual, te emerohet nje Bord i ri Drejtoresh te shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » i perbere si meposhte :

- a. Riemerohet zoti Robert Rogner jun. si Drejtor per nje tjeter periudhe siç parashikohet ne statutin e shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » ;
- b. Riemerohet zoti Klaus Ressmann, si Drejtor administrativ per nje tjeter periudhe siç parashikohet ne statutin e shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » ;
- c. Emerohet zoti Gerhard Stranner, nenshtetas austriak, si Drejtor i trete siç kerkohet nga statuti i shoqerise.

6. TE VENDOSSET QE zoti Klaus Ressmann, Drejtor administrativ i shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. », eshte i autorizuar te ekzekutoje dhe te jape ne emer te shoqerise te gjitha dokumentat e nevojshme per te zbatuar vendimet e mesiperme dhe ne pergjithesi per te bere çdo gje te nevojshme per te plotesuar dhe bere efektive transferimin e pjeseve te kapitalit dhe emerimet ne Bord te pershkurara si me siper, duke perfshire por pa u limituar ne emerimin e Bordit te ri, partnerit te ardhshem Rogner International Hotels & Resorts GmbH dhe shperndarjen e re te pjeseve te kapitalit ne shoqeri, regjistrimin ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se rrethit te Tiranes dhe me çdo lloj autoriteti tjeter shqiptar, siç kerkohet nga ligji shqiptar.

Ju lutem vendosni voten tuaj duke nenshkruar me poshte dhe kthejini nje kopje te ketij dokumenti me fax zotit Klaus Ressmann, shoqeria « Shqiponja e Arte sh.p.k. » c/o Rogner GmbH, Breitenfurterstrasse 118, A-1230, Viene, Austri (fax : +43-1-80 45 247) dhe dergoni du origjinale te nenshkruar me poste te regjistruar.

Faleminderit per bashkepunimin.

(nenshkrimi)

« Shqiponja e Arte sh.p.k. »
Robert Rogner jun. President

Shqiponja e Arte sh.p.k.

Ortaket e shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. » hodhen voten e meposhtme per sa i perket 6 vendimeve mbi transferimin e 982 pjeseve te kapitalit dhe emerimin e Bordit te Drejtoreve te shoqerise « Shqiponja e Arte sh.p.k. », vendime te propozuara ne menyre qarkulluese me 2 prill 2004.

Votimi :

Vendimet aprovohen :

Ortaku BERZH _____ (Firma)

Emri, pozicioni : Mary Ellen Collins, Drejtor

Vendi, data : Londer 07 prill 2004

Vendimet hidhen poshte :

Ortaku BERZH _____
Emri, pozicioni

Vendi, data : _____

Vendimet aprovohen :

Ortaku Rogner GmbH _____
Robert Rogner sen, Drejtor administrativ

Vendi, data : _____

Vendimet hidhen poshte :

Ortaku Rogner GmbH _____
Robert Rogner sen, Drejtor administrativ

Vendi, data : _____

Përkthues

Flanjo Baxici

F

Shqiponja e Arte sh.p.k.

Republika e Shqiperise
Dhoma e notereve
Tirane
Nr 991 Rep

Tirane, me 25 maj 2004

VERTETIM

Vertetohet firma e perkthyeses Flonja Boriçi, banuese ne Tirane, e njohur personalisht prej meje noteres, e cila me deklaroi se perktheu saktesisht, nga gjuha angleze ne gjuhen shqipe, dokumentat bashkelidhur dhe nenshkroi rregullisht ne pranine time.

Notere
Irena Laha



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA E TIRANES

Nr. 10430/4

Tirane, 8 Dhjetor 1993

Shqiponjes se Arte Sh. P. K.

Per njoftim : BERZH

Keshillit te Pergjithshem

Londer

Te dashur Zoterinj,

Ketu me poshte vertetojme se, Republika e Shqiperise ka titullin e plote dhe te paster te pronesise ne parcelen e tokes prej 15350 m² (pesembedhjetemije e treqind e pesedhete metra katrore me dimensione 96.25m x 159.25m), te quajtur me poshte "Prona", qe ndodhet ne Tirane ne Bulevardin "Deshmoret e Kombit", te kufizuar prej Kruges "Ismail Qemali" ne anen veriore, parcelave qe pretendohen nga pese familjet e permendura me poshte ne anen lindore, Pallatit te Kongreseve ne anen jugore dhe Bulevardit "Deshmoret e Kombit" ne anen perendimore, sikurse pershkruhet me mire ne harten bashkelidhur te Prones (pasqyra nr.1). Kjo Prone i eshte dhene me qira "Shqiponjes se Arte Sh. P. K. " me ane te ndryshimeve qe i jane bere marreveshjes se qirase te dates 22 Dhjetor 1992.

Ne vertetojme ketu se, i) Prona ka qene poseduar nga Republika e Shqiperise te pakten qysh nga 1937, dhe ii) Republika e Shqiperise gezon titullin te transferoje te gjitha ose ndonje prej te drejtave te saj ne lidhje me kete Prone.

Prona kufizohet me kater parcela qe i jane dhene gjithashtu me qira "Shqiponjes se Arte Sh. P. K." ne baze te Marreveshjes se Qirase te lartpermendur, te cilat, sipas Rregjistrit Zyrtar qe ka Zyra e Kadastrës dhe Planit te qytetit te Tiranes te vitit 1937 qe ka Drejtoria e Urbanistikës (pasqyra nr. 2), jane rregjistruar si me poshte:

- | | | | |
|------------------------|------------------------------|------------------|---------|
| 1. Prone e paluejtshme | prej 1,100 m ² me | nr. rregjistrimi | 239/66; |
| 2. Prone e paluejtshme | prej 1,100 m ² me | nr. rregjistrimi | 241/64; |
| 3. Prone e paluejtshme | prej 1,100 m ² me | nr. rregjistrimi | 243/62; |
| 4. Prone e paluejtshme | prej 1,100 m ² me | nr. rregjistrimi | 245/60; |
| 5. Prone e paluejtshme | prej 1,200 m ² me | nr. rregjistrimi | 247/58. |

Me poshte vertetojme se Republika e Shqiperise ka titullin e plote dhe te paster te pronesise ne parcelat e identifikuar me nr. 239/66, 241/64, 243/62, 247/58 dhe 245/60. Ne baze te Ligjit nr. 7698 te 15 Prillit 1993 ("Per Rikthimin dhe Kompensimin e ish-Pronareve"), pretendime per rikthimin e ketyre parcelave jane bere nga pretenduesit e meposhtem:

1. Terenc Toci pretendon rikthimin e parceles nr. 239/66;
2. Yzedin Beshiri pretendon rikthimin e parceles nr. 241/64;
3. Teki Selenica pretendon rikthimin e parceles nr. 243/62;
4. Drita Demiraj pretendon rikthimin e parceles nr. 245/60.

Ne perputhje me Vendimin nr. 10430 te 22 Nentorit 1993 te Komitetit te Rikthimit dhe Kompensimit (pasqyra nr. 3), kerkesat jane refuzuar dhe, keta pretendues jane kompensuar me disa parcela te tjera toke, sikurse parashikohet nga Ligji i lartpermendur Nr. 7698.

Deri me sot nuk eshte bere asnje pretendim per rikthim per sa i perket parceles nr. 247/58. Sipas Dekretit Ministerial nr.301/92 data e skadimit per paraqitjen e nje pretendimi nga ish-pronari i kesaj parcele, neqoftese ka, eshte 15 Mars 1994.

Tuajet me shume vertetesi

Kryetari i Drejtorise se Urbanistikes

Koço Kaskaviqi

Kryetari i Zyres se Kadastres

Sinan Koçaj

Kryetari i Bashkise se Tiranës

Sali Kelmendi



Kryetari i Komitetit te Rikthimit dhe Kompensimit te Pronave

Gafur Luga

3709/18

SB MUCG
18 02 2005

18 SHKURT 2005



REPUBLIKA E SHQIPERISE

KERKESE

KERKUES: Shoqeria "Shqiponja e Arte" sh.p.k. ("Golden eagle" sh.p.k.)

Objekti: Kerkohet pasqyrimi ne Regjistrin Tregtar i transferimi te 261 pjeseve te kapitalit te shoqerise me nje vlere nominale prej 1000 (njemije) US dollare secila, prej Bankes Europiane per Rindertim dhe Zhvillim ne pronesine e Rogner International Hotels & Resorts GmbH.

Per kompetence:

Toi depozitohet
kerkesa dt
GJKATES SE RRETHIT 21.02.05
TIRANE

Shoqeria "Shqiponja e Arte" sh.p.k. ("Golden Eagle" sh.p.k.) eshte person juridik, i regjistruar me Vendim Nr.3709, date 27.04.1992 dhe ri-regjisruar ne date 05.06.1993 me Vendimin Nr.3709/1, me:


- Ortake (1) Rogner GmbH; (2)Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim (3) Rogner International Hotels & Resorts GmbH;
- Kapital themeltar; 8.800.000USD
- Perfaqesues i Shoqerise: Z.Klaus Ressimann, Drejtor Administrativ
- Selia: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Nr.8, Tirane, Shqiperi.

Tout noté transféré
Nr 4P8/116
dt 2.02.05
(Ange supip)

Meqenese:

1. Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim zoteron 1518 pjese te kapitalit te shoqerise "Shqiponja e Arte" sh.p.k.;
2. Rogner International Hotels & Resorts GmbH zoteron 982 pjese te kapitalit te shoqerise "Shqiponja e Arte" sh.p.k.;
3. Me ane te nje kontrate transferimi te pjeseve te kapitalit, ne formen e aktit noterial dhe te nenshkruar para noterit me daten 9 shkurt 2005, ortaku Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim transferon ne pronesine e ortakut Rogner International Hotels & Resorts GmbH, 261 pjese kapitali;
4. Ne baze te nenit 49 te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite Tregtare", dhe nenit 11 te statutit te shoqerise "Shqiponja e arte" sh.p.k pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.

Autonome dt
02.02.05
Certificate
B.P.Zh
dt 20.11.05
Agjuria
supip




Kerkohet:

- Te pasqyrohet sa me siper ne Regjistrin Tregtar.
- Te depozitohet kontrata e transferimit te 261 pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise "Shqiponja e arte " sh.p.k., nga ortaku Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim ne pronesine e ortakut Rogner International Hotels & Resorts GmbH, nenshkuar ne Tirane, perpara noterit, ne formen e nje akti noterial, me 9 shkurt 2005, nga perfaqesuesit me prokure te te dyja shoqerive.

"Shqiponja e Arte" sh.p.k.

Perfaqesuesi
Klaus Ressimann
Drejtor Administrativ



KLAUS RESSMANN



Republika e Shqiperise
Dhoma e Notereve Tirane
Nr. ~~499~~ Rep



Vertetim


Sot me date 09.02.2005 u paraqit perpara meje Noteres se Dhomes se Notereve Tirane, Arjana Mallkuçi, Z. Klaus Joseph Ressmann, shtetas Austriak, dtl.1941, me adrese: Durergasse 15,A-1060,Viene, Austri, ne cilesine e Drejtorit Administrativ te Shoqerise "Shqiponja e arte Sh.p.k.", madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i cili me deklaroi se sa me siper eshte nje kerkese e shoqerise "Shqiponja e arte Sh.p.k.", redaktuar jashte kesaj zyre, te cilen e firmosi ne prani te perkthyeses Flonja Boriçi (Tashko), rregullisht dhe me vullnet te lire dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Dhoma e Notereve Tirane
NOTERE
Arjana Mallkuçi

Republika e Shqiperise
Dhoma e Notereve
Tirane

Nr. 498 Rep/

Nr. 186 Kol



Tirane, me 9 shkurt 2005

KONTRATE TRANSFERIMI TE PJESEVE TE KAPITALIT

Sot, me daten 9 shkurt 2005, para meje noteres Arjana Mallkuçi, anetare e Dhomes se Notereve, u paraqiten personalisht palet ne kete kontrate :

Shitesi : Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim (BERZH), nje organizate nderkombetare me seli ne One Exchange Square, London EC2A 2JN, Mbreteria e Bashkuar, perfaqesuar nga zoti Murat Yildiran, lindur me 21 korrik 1962, ne Pulumur, Turqi, banues ne Hotel Sheraton, Sheshi Italia, Tirane, nenshtetas turk, me pashaporte nr. TR H 608949, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar prej meje, me prokure te posaçme nr. G569434, te dates 30 nentor 2004, leshuar nga Ministria e Jashtme dhe e Komunitetit te Perbashket (Commonwealth), ne Londer, vertetuar nga Noteri publik SONI & C.

Bleresi : Rogner International Hotels & Resorts GmbH, nje shoqeri e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjit austriak me seli ne 118 Breitenfurterstrasse, A-1230 Viene, Austri, perfaqesuar nga zoti Klaus Ressmann, lindur me 10 qershor 1941, banues ne Duerergasse 15, A-1060 Viene, Austri, nenshtetas austriak, me numer pashaporte J 0555123 3, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar prej meje, i pajisur me prokure te posaçme nr. BRZ 412 / 2005, te dates 02.02.2005, leshuar nga Klaus Hofmann, vertetuar nga noteri publik Dr Peter Zdesar, ne Villach.

Te pergjithshme

A. Shitesi zoteron 1,518 pjese kapitali ne kapitalin e shoqerise « Shqiponja e Arte » sh.p.k ., nje shoqeri qe ekziston sipas ligjeve shqiptare, regjistruar ne Gjykatën e rrethit te Tiranes, me 5 qershor 1993 me Vendim numer 3709 / 1, me seli ne Bvd. Deshmoret e Kombit (Hotel Europark), Tirana, Shqiperi, (« Shoqeria ») ;

B. Bleresi zoteron 982 Pjese Kapitali ne kapitalin e shoqerise « Shqiponja e Arte » sh.p.k. ;

C. Ne perputhje me nenin 11.1. te statutit te shoqerise dhe me nenin 49 te Ligjit Nr. 7638, date 1992 « Per Shoqerite Tregtare », pjeset e kapitalit mund te transferohen lirisht ndermjet ortakeve te shoqerise.

Palet bien dakort si me poshte :

m w

255


1. Shitesi konfirmon qe eshte paguar plotesisht nga Bleresi, sipas çmimit te rene dakort me te dhe si rrjedhim, ai transferon, ne pronesine e Bleresit, 261 pjese kapitali me nje vlere nominale prej 1000 (njemije) US Dollare secila, nga 1518 pjeset e kapitalit qe ai zoteron ne kapitalin e shoqerise « Shqiponja e arte sh.p.k . » . Shitesi garanton Bleresin qe 261 pjeset e transferuara te kapitalit te jane krejttesisht te lira nga çdo peng dhe barre.

2. Bleresi pranon pronesine e 261 pjeseve te kapitalit te mesiperm, te lira nga çdo peng dhe barre dhe pranon te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga pronesia e ketyre pjeseve te kapitalit ne Shoqeri, sipas Statutit te Shoqerise.

3. Shitesi dhe Bleresi pranojne te zbatojne e te japin, me kerkese te pales tjeter dhe/ose Shoqerise, te gjitha dokumentacionin e duhur ne pergjithesi, per te kryer çdo gje te nevojshme per transferimin e pjeseve te kapitalit, qe jane objekt i kesaj kontrate, dhe per te regjistruar kete transferim ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se rrethit te Tiranes, si edhe ne çdo organ tjeter shqiptar sipas ligjeve shqiptare.


Kjo kontrate u perpilua ne 4 (kater) kopje me vlere te njejte ligjore. Kontrata eshte bazuar ne Ligjin nr. 7638, date 19.11.1992, « Per Shoqerite Tregtare ». Kontrata u lexua para paleve, u gjend e rregullt, ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, dhe u nenshkrua ne menyre te rregullt, nga palet, perpara meje, dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

Bazuar ne Ligjin Nr. 7829, date 01.06.1994 « Per Noterine », komunikimi me palet e huaja u krye ne anglisht, nga perkthyesja Flonja Boriçi (Tashko), lindur me 22.07.1972 ne Tirane, banuese ne Tirane, ne adresen Rr. Budi 53, Shqiperi, mbajtese e pasaportes nr. Z0898509.




Rogner International Hotels
& Resorts GmbH, Bleresi

Emri : Klaus Rössmann



Banka Europiane per
Rindertim dhe Zhvillim,
BERZH, Shitesi

Emri : Murat Yildiran




REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR. 7334 Rep.

VERTETIM

Vertetohet firma e perkthyesit *Evisa Shehaj*, e njohur personalisht prej meje,
e cila perktheu sa me siper nga anglishtja ne shqip, njelloj me originalin dhe
nenshkroi para meje dhe une Noterja e vertetoj.

Tirane 13.12 2005



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 333 REP

VERTETIM

Sot ne daten 13.12.2005 (dymije e pese) perpara meje Noteres MIMOZA SADUSHAJ, Notere prane Dhomes se Noterise Tirane me adrese Rr. " Vaso Pasha ", P. 13, u paraqit personalisht Z. Murat Yildiran lindur me 21.07.1962, ne Pulumur Turqi, banues ne Tirane, shtetas turk, me pasaporte TR H 608949 , I cili me paraqiti nje prokure origjinale te dates 06.10.2005 leshuar nga Nigel Carter dhe une noterja vertetoj se fotokopja eshte e njejte me origjinalin e paraqitur prej tij.

NOTERE

MIMOZA SADUSHAJ



SONI & C^o

Noter Publik

ZYRA NE KENSINGTON
Rr. Ansdell 23
LONDON W8 5BN
Tel: 08456120130
Fax: 020 7938 2050
DX 47233 Kensington High Street
E_mail: enqueries@notary-soni.com

ZYRA NE LONDER
1 Royal Exchange Avenue
LONDON EC3M 5BN
Tel: 08456120130
Fax: 020 7938 2050
DX 47211 Kensington High Street
E_mail: enqueries@notary-soni.com

Per te gjithë te interesuarit , PRITESH VALLABHDAS SONI banues ne rrugen Fenchurch 10, ne qytetin e Londres, NOTER PUBLIK, me autoritetin mbreteror , vertetesisht dhe betuar si i tille, VERTETOJ vertetesine e nenshkrimit te « Nigel Karter » ne certifikaten bashkalidhur, si te tijen te vertete dhe te nenshkruar nga NIGEL CARTER, Nen/sekretar I Pergjithshem i BANKES EUROPIANE PER NDERTIM DHE ZHVILLIM (qe do te quhet «Banka »), ne One Exchange Square London EC2A 2JN;

DHE NE VIJIM UNE VERTETOJ vertetesine e vules se Bankes me te cilen eshte vulosur certifikata bashkalidhur dhe se i nenshkruari Nigel Karter eshte autorizuar te vleresoje kete vule sipas nje urdhri administrativ te dates 3 Tetor 1994.

DHE NE VIJIM UNE VERTETOJ vertetesine e nenshkrimit te « Ilaria Benucci » ne aktin e autorizimit per nenshkrimin qe gjendet bashkalidhur meAktin e Autorizimit per nenshkrim, te dates 6 Tetor 2005, si te veten , te vertete dhe te nenshkruar nga vete ILARIA BENUCCI, Drejtore, Pronat dhe Turizmi ne Banke, e autorizuar per te nenshkruar Aktin e Autorizimit per Nenshkrim sipas urdherit administrativ te mesiperm.

ME BESIM DHE SIPAS KESAJ DESHMIE, une kam vene emrin tim dhe vulosur me vulen e zyres time ne Kensington, Londer, me 29 Nentor te vitit dymije e pese.

Pritesh Soni

Noter Publik

Pulla

Vula

SONI & CI
NOTER

295

APOSTILE
(CERTIFIKATE LEGALIZIMI)

Konventa e Hages me 5 tetor 1961

MBRETERIA E BASHKUAR E BRITANISE SE MADHE DHE IRLANDES SE VERIUT

1. Shteti : Mbreteria e Bashkuar e Britanise se Madhe dhe Irlandes se Veriut

Ky akt publik

2. Eshte nenshkruar nga Pritish V Soni

3. Ne cilesine e Noterit

4. Mban vulen e Noterit te mesiperm

5. Ne Londer

6. Eshte vertetuar me 30 Nentor 2005

7. Nga Sekretari i Shtetit Principal i Madherise se saj ne Marredheniet me Jashte ne Commonwealth.

8. Numer : G869157

9. Vula

(Vula e Zyres per Marredheniet me Jashte te Commonwealth, Londer)

10. Nenshkrimi P. Hunting

(Firma per Sekretarin e Shtetit)

Nese ky dokument do te perdoret ne nje shtet i cili nuk ben pjese ne Konventen e Hages se dates 5 tetor 1961, ai duhet te paraqitet ne seksionin konsullar te misionit qe perfaqeson kete shtet. Apostila apo certifikata e legalizimit vetem konfirmon vertetesine e nenshkrimit dhe vules ne dokument. Kjo nuk do te thote qe permbajtja e dokumentit eshte e sakte apo qe Zyra e Marredhenieve me Jashte te Commonwealth miraton kete permbajtje.

CERTIFIKATE

Nigel Karter Nen/sekretar I Pergjithshem i Bankes EUropiane per Rindertim dhe per Zhvillim (Banka), deklaroi si me poshte :

(a) Neni 30 paragrafi 4 i Marreveshjes qe Themelon Banken (Marreveshja) thote :

“Presidenti do te jete perfaqesuesi ligjor I Bankes”

(b) Sipas nje Urdhri Administrative te dates 3 tetor 1994 me titull “ Nenshkrimi I Instrumentave ne Forme te Shkruar : Per Caktimin e Zyrtareve “, sic eshte ndryshuar nga kjo date (Urdheri Administrativ) , nenshkruar nga Presidenti ne baze te nenit 30, paragrafi 4 te Marreveshjes keta qe vijojne : Zevendes Presidenti i Pare I Bankes, Departamenti i Veprimeve Bankare, Nen/Zevendes Presidenti, Departamenti i Veprimeve Bankare, Nen/ Zevendes Presidenti, Zevendes Presidenca e Finances , dhe cdo Drejtor I Grupit te Bisnesit , Departamenti I Veprimeve Bankare , Drejtoret e Grupeve te Punes , Departamenti I Veprimeve Bankare ose Nen/drejtoret e Grupeve te Punes, Departamenti I Veprimeve Bankare mund te nenshkruajne dokumentat e permendura ne pikat (1), (2), (3), (4):

(1) Marreveshjet dhe instrumentata me ane te cilave banka mer persiper te jape hua , investime nepermjet kapitaleve private , angazhime garancie dhe sigurimi apo per te marre persiper operacione te ngjashme , duke perfshire marreveshje huaje , marreveshje abonimi, marreveshje per blerje aksionesh dhe te pritshme.

(2) Marreveshjet dhe instrumentat qe do te ekzekutohen perpara dhe ne zbatim te marreveshjeve te permendura ne piken 1 , duke perfshire leter mandatet , nderrmarjet konfidenciale , marreveshjet e agjensise, zbatimin e tyre ose marreveshjet e bashke financimit, marreveshjet per projekte , marreveshje apo intrumente qe japin garanci apo siguri ne favor te Bankes , marreveshjet e ndarjes se sigurimit , marreveshtjet ndermjet kreditoreve , marreveshjet qe kane te bejne me tjetersimin e asetave mbi te cilat Banka ka nje interes sigurimi, marreveshjet per fondet e financimit te projekteve , marreveshje per perfundimin apo mbeshtetjen e projekteve, marreveshje menazhimi, marreveshje pjesemarrjeje, kalim huaje apo marreveshjet e e zevendesimit te kontrates ekzistuese, marreveshje per trajtimin e aksioneve ne treg dhe marreveshjet e terheqjes se kapitaleve

(3) Shtesat ndryshimet njoftimet kerkesat dhe te rejat mbi marreveshtjet dhe instrumentat sipas pikave 1 ose 2 , perfshire njoftimet per rishikimin e grafikut te amortizimit , njoftimet e pezullimit apo shuarjes, njoftimet e heqjes dore apo pelqimit , njoftimet e mospermbushjes dhe njoftimet e persheptimit.

(4) Prokurat per kezekutimin e dokumentave sipas pikes 1 ose 2 ose 3 mesiper; prokurat per mbledhjet e aksionereve dhe kreditoreve ; marreveshjet e shperblimit ndermjet Bankes dhe te caktuarve prej saj te cilat veprojne si drejtor te kompanive net e cilat eshte kryer investimi.

(c) Ilaria Benucci eshte Drejtor Grupi, Departamenti i Veprimeve Bankare.

257

CAKTIMI I NENSHKRUESIT TE AUTORIZUAR

Per te permbushur kompetencen qe me eshte dhene nga Urdhri Administrative i dates 3 tetor 1994 me titull "Nenshkrimi i Instrumentave ne Forme te Shkruar : Per Caktimin e Zyrtareve", ndryshuar nga kjo date , nenshkruar nga Presidenti i Bankes Europiane per Rindertim dhe per Zhvillim ("Banka"), ne baze te nenit 30 paragrafi 4 i Marreveshjes qe Krijon Banken , une i nenshkruari autorizoj Murat Yildiran, Bankier Senior dhe Drejtor i Zyres se Tiranes qe te nenshkruajne per dhe ne emer te Bankes cdo dhe te gjitha instrumentat ne forme te shkruar per transferimin e aksioneve sipas urdhrimit pjesor te nje opsioni te vendosur qe ushtrohet ne perputhje me dokumentat e financimit te ekzekutuara nepermjet, *inter alia* , Bankes dhe Golden Eagle shpk , shoqeri e cila eshte themeluar dhe ekziston sipas ligjeve te Shqiperise.

Autorizimi per te nenshkruar do te jete ne fuqi deri me 6 janar 2006, perfshire edhe kete date. Ky autorizim jepet ne vazhdim, pa kufizuar autorizimet e dhena me pare dhe mbarimi apo perfundimi i mundshem i afatit te ketij autorizimi nuk do te preke asnje veprim te kryer me pare apo qe do te kryhet per ushtrimin e kesaj kompetence.

Nenshkruar ne Londer me 6 tetor 2005.

(nenshkrimi)

Ilaria Benucci

Drejtore Grupi, Departamenti i Veprimeve Bankare

EVISA SHEHAJ
PERKTHYESE
TRANSLATOR
Tel. 0692291751

REPUBLICA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 7331 REP



VERTETIM

Sot ne daten 13.12.2005 (dymije e pese) perpara meje Noteres MIMOZA SADUSHAJ, Notere prane Dhomes se Noterise Tirane me adrese Rr. " Vaso Pasha ", P. 13, u paraqit personalisht Z. Klaus Ressmann, lindur me 10.06.1941, shtetas austriak, madhor me zotesi juridike per te vepruar me nr pasaporte J 05551233 ,aktualisht banues ne Tirane , I cili me paraqiti nje prokure origjinale te dates 07.12.2005 leshuar nga Klaus Hofmann dhe une noterja vertetoj se fotokopja eshte e njejte me origjinalin e paraqitur prej tij.

PULLE TAKSE

NOTERE

MIMOZA SADUSHAJ



PROKURE E POSACME

STATI QE I PERKET

